

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7888 E hënë 20 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

Gazetari Peter Tiede u bë këto ditë shumë i njohur tek ne, edhe pse janë të paktë ata që e kanë lexuar shkrimin e tij për ne nga fillimi deri në fund. Shumica...  
Vijon në faqen 20

Furtuna "Bild" dhe e vërteta shqiptare



Kritikë

Artistike

Nga JOSIF PAPAGJONI

Epashë me vonesë shfaqjen "Engjëjt e Amerikës" të Teatrit Kombëtar, dramë e amerikanit Anthony Kushner; fituese e çmimit të njohur "Pulizer". Teksa njëri nga...  
Vijon në faqen 21

Engjëjt e Amerikës



Toman: Jam mirënjohës që pronari ka zgjedhur teknologjinë çeke

## Shtatë ambasadorë impresionohen me birrën "Korça": Zgjedhja jonë

Diplomatët e Maqedonisë së Veriut zgjodhën të vizitojnë ambientet e birrës së parë shqiptare

Fabrika e birrës "Korça" është kthyer në magnet për vizitorët e huaj. Kësaj radhe ambasadorë nga Maqedonia e Veriut dhe një grup turistësh gjermanë shijuan të sapo prodhuar birrën e parë shqiptare. Shijen e saj e krahasojnë me birrën në vendet e tyre Shtatë ambasadorë të huaj nga Maqedonia e Veriut zgjodhën të vizitojnë këtë fundjavë ambientet e birrës së parë shqiptare...  
Në faqen 9

LISTA ME DOKUMENTACIONIN QE DUHET TE DOREZOJNE TE MOSHUARIT TEK ISSH

## RILLOGARITJA E MASES SE PENSIONIT, JA KUSH PREKET

Koeficientët e rinj për pensionet e pleqërisë. Formula, si të llogarisni saktë pensionin dhe si veprohet për kontributet e paguara deri në 1994-ën



(Në foto) Foto ilustruese

NE DHOMEN E LORDEVE

Basha: Zgjedhjet e lira jetike për legjitimitetin e qeverisë së re

Në faqen 3

ZBARDHET DOSJA

Përgjimet, ja si i justifikoi Dako bisedat me "Niçen" në prokurori

Në faqen 2

RAPORTI

Përgjimet e prokurorisë, sa u proceduan në vitin 2018

Në faqen 10-11

KONTROLLET

Gëlltiti 22 doza droge, ekografia nxjerr zbuluar të burgosurin

Në faqen 5

LISTA E PLOTE



Tapi toke për 2000 familje, kush përfiton e ç'duhet të bëni

Në faqen 4

Ylli Merja: Si të trajtoni dhimbjet e kyçeve brenda një jave. Efektet e mrekullueshme të vajit të sinapit

## Lorela Garuli: Fëmijët me dhunti më të larta se mesatarja

ISHP: Mënyra të thjeshta për t'u mbrojtur nga temperaturat e larta

Nga VOLTIZA DURO

Shoqëritë me një të kaluar shtetlindore kanë tendencë të shuajnë diferencat e pranishme mes individëve të shoqërisë dhe prirjen drejt mesatarizimit social, klasor dhe intelektual. Sot për sot, në Shqipëri ndihmohen dhe



nxiten të integrohen individë me vështirësi, çrregullime dhe problematika të ndryshme të zhvillimit, ndërkohë që ka shumë pak vëmendje për fëmijët dhe të rinjtë që kanë dhunti apo talente të caktuara. Në një intervistë për suplementin "Life Pages"...

Suplement

## BLERJA E VOTAVE PËRGJIMET

Kreu i Bashkisë së Durrësit ka mohuar që të ketë kërkuar blerjen e votave në 2017

# Përgjimet, ja si i justifikoi Dako bisedat me "Niçen" në prokurori

*Kryebashkiaku u pyet të enjten më shumë se 5 orë në prokurori*


Injoh Avdyllajt, por nuk u kam kërkuar të pagua një për të blerë vota". Ka qenë kjo me pak fjalë përgjigja e kryetarit të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako në seancën maratonë pasditen e së enjtes së javës së kaluar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Kështu raporton Lapsi.al, i cili duke iu referuar burimeve nga prokuroria thekson se prokurorët Vladimir Mara dhe Dritan Premçi e kanë pyetur hollësisht për të gjithë personat që shfaqen në dosjen "e famshme" 339. Në fakt, mësohet se ky hetim është veçuar nga Dosja 339 që në maj të vitit 2017 duke hapur një çështje të re të quajtur 339/1. Veçimi i kësaj dosjeje u bë i nevojshëm pas daljes së përgjimeve të famshme të Dakos me "Niçen" e Shijakut (Altin Avdyli) që tashmë ndodhet në qeli i akuzuar si pjesë e një grupi të strukturuar të trafikut të drogës dhe tjetërsimit të pronave në bregdet. Por burimet e rezervuara në organin e akuzës thanë se pas zbardhjes së mbi 700 CD-ve, krahas Dakos, jozyrtarisht mësohet se u kanë dalë emrat edhe disa zyrtarëve të tjerë të pushtetit vendor, si dhe disa gjyqtarë e prokurorë, të cilët mund të pyeten në vazhdim të hetimeve. Ndaj gjatë javës që u mbyll, derën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda e kanë kaluar edhe persona të tjerë të lidhur me dosjen 339, të gjithë pjesë e shtabit elektoral të Vangjush Dakos në zgjedhjet e 2017-ës. Gjithashtu, mësohet se në rrëfimin e tij prej 5-orësh të së enjtes Vangjush Dako ka treguar si është njohur me vëllezërit Astrit dhe Altin Avdyllaj, me të cilët ka folur para dhe pas zgjedhjeve. "Qytetari i parë" i Durrësit mësohet se ka mohuar të ketë dënuar mbi blerjen e votave. Para prokurorëve ai nuk e ka mohuar që persona të ndryshëm mund të kenë ofruar lekë kundrejt votave, por duke theksuar se ai vetë personalisht nuk ka pasur dje-



Kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako

### QEVERIA GJERMANE I KËRKON BUNDESTAGUT TË MARRË VENDIM PËR NEGOCIATAT

Qeveria gjermane i kërkon Bundestagut gjerman të marrë vendimin për hapje e bisedimeve për anëtarësimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në union. "Pas dakordësisë në konkluzionet e Këshillit Evropian të 26 qershorit, në vitin 2018, për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, që përcaktoi datën për hapjen e negociatave në qershor 2019 kemi kërkuar rezultate më të prekshme për progresin mbi reformat për Shqipërinë në pesë fushat kryesore të drejtësisë, administratës publike, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe të drejtat e njeriut", - shkruan Majkëll Rut në letrën drejtuar Bundestagut.



Një nga protestat e opozitës

### Integrimi, Bushati: Duhet përgjegjshmëri politike nga Shqipëria

Ish-ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati i bëri apel palëve politike në Shqipëri që të gjejnë konsensusin për t'i dhënë fund krizës politike, si një domosdoshmëri në prag të marrjes së datës për hapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Sipas tij situata aktuale politike në Shqipëri mund të reflektohet në vendimin përfundimtar të vendeve anëtare. Ndaj ai bëri apel për përgjegjshmëri të brendshme. "Sigurimi i konsensusit tek vendet anëtare, bazuar tek përsëritja e një rekomandimi që do të vinte nga Bashkimi Evropian, do duhet të shoqërohet dhe me përgjegjshmëri politike që do duhet të vijë nga Shqipëria", - tha Bushati për Vizion Plus. Sa i përket raportit që pritet të publikohet ai nënvizon se nuk është ky hapi ku Tirana duhet të përqendrojë vëmendjen, por tek data se kur do hapen negociatat. Ai sjell rastin e Maqedonisë e cila edhe pse për shumë vote ka pasur një raport pozitiv, nuk i ka hapur dot negociatat. "Ne jemi në kushtet kur pritshmëria kryesore duhet të jetë për datën dhe jo më për raportin. Duhet të kujtoj që Maqedonisë së Veriut nga 2009 nuk i ka munguar një rekomandim nga Komisioni Evropian që shoqëronte Raportin e Progresit apo raportin vjetor; dhe në një dekadë pavarësisht se kishin mënyrë të përvitshme përsëritjen e rekomandimit, nuk e pati të mundur të fillonte bisedimet për anëtarësim. Prandaj në këtë moment fokusi ynë kryesor duhet të jetë sigurimi i konsensusit brenda vendeve anëtare në mënyrë që Shqipërisë t'i jepet data", - tha Bushati.

## PD lista e zgjedhësve me problem, Doracaj: Nuk ka pasur asnjë ankesë



Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, Bledar Doracaj

Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim dorëzuan para dy ditësh kandidatët e tyre për anëtarë KZAZ-sh me pretendimin se gjatë procesit të përgatitjes dhe administrimit të zgjedhjeve po kryhen shkelje të mëdha ligjore. Një prej shqetësimeve të ngritura nga opozita ishte edhe pasaktësitë e mëdha që ekzistojnë në listën paraprake të zgjedhësve dhe që shumë shpejt pritet të publikohet si lista përfundimtare. Por Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, Bledar Doracaj ka hedhur poshtë këto akuzë, duke theksuar se deri më tani kjo drejtori ka publikuar plotë 6 ekstrakte të listës zgjedhore që buron nga regjistri kombëtar i gjendjes civile. Sipas tij pavarësisht se lista është publikuar 6 herë, asnjë forcë politike dhe asnjë subjekt

tjetër zgjedhor nuk ka ngritur pretendime mbi saktësinë e saj. Ndaj ai thekson se këto pretendime të opozitës nuk qëndrojnë. "Kemi publikuar ekstraktin e parë elektronik në datën 20 nëntor dhe pastaj në çdo fund muaji sipas për-

torisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile nuk ka ardhur asnjë ankesë nga asnjë subjekt politik", - tha Doracaj. Ndërkohë nga ana tjetër ai ka garantuar se fenomenet e ndodhura në zgjedhjet e mëparshme ku në prag zgjedhesh bëheshin lëvizje të orientuara zgjedhësish në zona të caktuara nuk do të përsëriten. Ai u shpreh se drejtorija që ai drejton po monitoron situatën dhe nuk do të lejojë asnjë tentativë të tillë. "Jemi në monitorim të vazhdueshëm të lëvizjeve të pakontrolluara apo të orientuara dhe deri më tani nuk kemi konstatuar rastë të lëvizjeve të pakontrolluara apo të orientuara, në qoftë se i referoheni 2015, Kavajës apo Durrësit, nuk kemi rastë të tilla", - shtoi Doracaj.

anëtarëve të tjerë të këtij grupi të regjistruara gjatë përgjimeve zyrtare që prokuroria ka kryer për disa vepra penale. Të gjitha bisedat janë kryer gjatë harkut kohor nga shkurti i 2017 deri në qershor të 2017, pra deri në zgjedhjet parlamentare të atij viti, ku Dako drejtonte fushatën e PS-së për gjithë Qarkun Durrës.





Vetëm pak ditë pasi u betua në parlament si deputet, kryetari i Partisë së Pensionistëve të Shqipërisë, Selami Jenisherri rrezikon jo vetëm që ta lërë këtë mandat, por edhe të përballet tashmë në pleqëri me ligjin. Kjo pasi ai rezultoi të ketë mashtruar institucionet shtetërore sa i përket të shkuarës së tij penale. "News24" ka zbuluar se Selami Jenisherri ka gënjyer në plotësimin e formularit të dekriminalizimit të dorëzuar në KQZ duke fshehur një dënim të tijin të mëparshëm. Kështu rezultoi se ai është dënuar me 8 muaj burg nga Gjykata e Shkodrës në vitin 2001

## Fshehu dënimin, Selami Jenisherri rrezikon mandatin e deputetit



Deputeti i ri Selami Jenisherri

për akuzën e mashtrimit, vendim të cilin e ka apeluar në Gjykatën e Lartë dhe kjo e fundit ka lënë në fuqi dënimin. Pra, megjithëse bëhet fjalë për një vendim të

formës së prerë, në formularin e dekriminalizimit, Jenisherri thotë se nuk ka qenë në asnjë rast i dënuar si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Tashmë çështja i

kalon seksionit të dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme për të bërë verifikimet dhe më pas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kreu i Partisë së Pensionistëve Shqiptarë, Selami Jenisherri me shumë mundësi do të jetë deputeti që qëndroi më pak në sallën e parlamentit. Por ai rrezikon jo vetëm mandatin në këtë rast, por edhe sanksionet e tjera që parashikon kuadri ligjor shqiptar dhe konkretisht neni 190 i Kodit Penal që ka të bëjë me veprën e falsifikimit të dokumenteve zyrtare.

Kreu i PD zhvilloi një darkë pune me anëtarë të parlamentit dhe Dhomës së Lordëve

Në kuadër të vizitës së tij në Britaninë e Madhe, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ishte i ftuar ndëri në një darkë pune me anëtarë të parlamentit dhe Dhomës së Lordëve në Londër. Mes pjesëmarrësve në këtë darkë pune ishte Lordi George Robertson, ish-Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s dhe anëtar i Dhomës së Lordëve, si dhe deputetët Crispin Blunt, Sir Mark Lyall Grant, dhe Gavin Williamson, anëtar i parlamentit britanik dhe lidhësit të Konservatorëve dhe ish-ministër i Mbrojtjes. Gjithashtu, në darkë ishte i pranishëm edhe Sir Hugh Orde, ish Kryedrejtuksi i Shërbimeve të Sigurisë në Irlandën e Veriut. Siç njofton zyra e shtypit të PD-së në qendër të diskutimeve ishte siguria dhe stabiliteti në Europën Juglindore dhe kriza politike në Shqipëri. Në fjalën e tij gjatë darkës, kryetari i opozitës shprehu mirënjohjen për ndihmën e çmuar të Britanisë së Madhe për kapërcimin me sukses të sfidave jetike për paqen dhe stabilitetin në Ballkan, në veçanti, në luftën e Kosovës dhe procesin e pavarësimit të saj, në konfliktin e armatosur në Maqedoni e Marrëveshjen e Ohrit dhe, së fundmi, Marrëveshja e Prespës që shërben për të konsoliduar perspektivën afatgjatë euroatlantike të rajonit, duke garantuar anëtarësimin e saj në NATO. Basha ndau me parlamentarët britanikë qëndrimin e qartë dhe të vendosur të Partisë Demokratike se përpjekjet dhe diskursi mbi kufijtë dhe shkëmbimin e territoreve shkon kundër këtyre arritjeve, duke kërcënuar paqen dhe stabilitetin rajonal. Duke u ndalur te situata politike në Shqipëri kryedemokrat i informoi politikanët britanikë me përpjekjen që po bën opozita shqiptare për të shkëputur lidhjet e krimit dhe qeverisjes në vend dhe kthimin e legjitimitetit të institucioneve vendimmarrëse. "Autokratët e korruptuar përbëjnë një kërcënim për

# Basha: Zgjedhjet e lira dhe të ndershme, jetike për legjitimitetin e qeverisë

"Hapi më emergjent, shkëputja e lidhjeve mes krimit dhe politikës"



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha gjatë vizitës në Britaninë e Madhe

### ZGJIDHJA

"Forcimi i institucioneve demokratike, kontrolli dhe kufizimi i pushteteve, drejtësia e pavarur dhe zgjedhjet e lira janë parakusht për integrimin e vendeve tona në BE. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë jetike për demokracinë dhe legjitimitetin e qeverisë para qytetarëve. Për këtë qëllim hapi më emergjent është shkëputja e lidhjeve të provuara mes krimit të organizuar dhe politikës"

demokracinë dhe stabilitetin. Kriza e thellë në Shqipëri ilustroon qartë se pa demokraci dhe sundim të ligjit nuk mund të ketë stabilitet dhe as zhvillim ekonomik. Forcimi i institucioneve demokratike, kontrolli dhe kufizimi i pushteteve, drejtësia e pavarur dhe zgjedhjet e lira janë parakusht për integrimin e vendeve tona në BE. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë jetike për demokracinë dhe

për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë së politikanëve të kapur në bashkëpunim me krimin për vjedhjen e zgjedhjeve dhe do të përmbushë të gjitha parakushtet e ngarkuara me ligj për të garantuar votën e lirë. "Vetëm një qeveri e dalë nga vota e lirë mund të luftojë krimin e organizuar që e ka shndërruar Shqipërinë, sipas raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, në një bazë operationale të rrjeteve kriminale, që veprojnë nga Amerika në Europë dhe Lindjen e Mesme", - tha Basha në fjalën e tij. Gjithashtu, ai i njoftoi miqtë britanikë edhe me programin e Partisë Demokratike, në veçanti, me masat që do të marrë përmes vetingut të politikanëve dhe goditjes me tolerancë zero të krimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale. Kreu i opozitës shpjegoi se këto masa synojnë t'u japin fund trafikëve dhe pastrimit të parave të pista të krimit, në mënyrë që të hapet rruga për Shqipërinë e standardeve europiane me bazari para ligjit, liri dhe mundësi për të gjithë qytetarët e saj. Ai shprehu bindjen se me ndihmën e Mbretërisë së Bashkuar dhe partnerëve tanë strategjikë euroatlantikë, Shqipëria do ta kapërcëjë këtë krizë dhe do t'i japë fund tranzicionit të tejzgjatur përmes reformave të thella politike që do të cimentojnë kontrollin demokratik të qeverisjes nga qytetarët dhe sundimin e ligjit.

## Rudina Hajdari kundër Gjinushit: Po kthehet në "akademinë e prostatit"

Pas Partisë Demokratike, edhe deputetja demokrate Rudina Hajdari shprehet kundër zgjedhjes së ish-ministrit të fundit të Arsimit të regjimit komunist, Skënder Gjinushi në krye të Akademisë së Shkencave. Në të njëjtën linjë me ish-kryetarin e saj, Lulzim Basha, Hajdari thotë se kjo është një tjetër lëvizje e partisë për të përmbushur etjen për pushtet. "Më vjen keq për akademik A. Fugën, që përpiqet të përqasë metodologji ala postmoderniste të modelit francez, në një akademi të stilit "ala monist" të vjetëruar, me persona të dalë boje, të mbushur me moshën e tretë, që e kanë kthyer akademinë tonë në variantin qesharak të "akademisë së prostatit", - shprehet ajo. Hajdari nuk nguron ta cilësojë Akademinë e Shkencave edhe si "akademia e prostatit", duke i referuar këtu pikërisht tentativës për të zhvilluar zgjedhjet për kreun e Akademisë së Shkencave vetëm me një kandidaturo, atë të Skënder Gjinushit. "Zgjedhja e Gjinushit në krye të Akademisë së Shkencave, vërteton më së miri se parti nuk kursen as institucionet shkencore për të përmbushur delirin e pafundës për pushtet. Nuk ka se si të ndodhë ndryshe, revanshi i delirit për pushtet do të përmblytë gjithcka edhe institucionet shkencore. Padyshim, që ato do të duhen, që në kushtet e gremisjes së madhe të qeverisë, të shërbejnë me përunjësi, për të "pohuar shkencërisht" meritat e qeverisë delirmadhe", - shprehet Hajdari në komentin e vet.

### NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbarimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të III (Tretë), për shpërndarje pasurisë së paluajtshme: Njësi, me sip. 142 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 496/386+3-N2, Vol. 52, Fage 239, ndodhur në Lincë Dajç, Tiranë, në pronësi të: Shoqërisë "AGL" shp.k identifikuar me NIPT J71702004M. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën 4.465.843 (katër milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e shtyzet e tre) Lekë.

Ankandi do të zhvillohet më datë 24.05.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vasa Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinh@hotmail.com.

**RAPORTI**  
**KRIMI**

Organi i akuzës ka dorëzuar në Kuvend raportin mbi kriminalitetin në vend

# Prokuroria përgjoi 4168 persona në 2018, procedoi 715 prej tyre

*Qarku Durrës dhe Fier kanë krimin më të madh*

Mënyra më rezultative për zbulimin dhe provueshmëri në e krimin në vend mbeten përgjimet telefonike. Gjatë vitit 2018 ka rezultuar se në çdo 5 persona të përgjuar 1 prej tyre është proceduar për një veprë penale të caktuar. Të dhënat janë paraqitur nga Prokuroria e Përgjithshme në raportin vjetor të punës së saj për vitin 2019 që është dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë dhe ku jepet një pasqyrë e përgjithshme e punës së këtij institucioni, por edhe të kriminalitetit në vend. Kështu sipas këtij raporti gjatë vitit 2018 janë ekzekutuar gjithsej 3063 vendime për përgjim të autorizuar nga gjykata në hetimet paraprake, aplikuar në lidhje me 715 procedime penale. Nga këto, 147 procedime penale kanë qenë në kuadër të hetimeve të prokurorisë për krime të rënda. Për sa më sipër është mundësuar interceptimi për 4168 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale. Si rrjedhojë në sajë të kësaj teknike hetimore është arritur në arrestimin ose ndalimin e 619 personave të dyshuar për krime kundër personit, vepra penale në fushën e narkotikëve, korrupsionit e shpërdorimit detyrë, trafikje e kalim i paligjshëm i kufirit apo vepra të tjera të rënda, duke parandaluar kështu pasoja për shtetin e shëtitasit.

**RAPORTI**

Në raportin e saj Prokuroria e Përgjithshme thekson se gjatë vitit 2018 janë përfunduar 30615 çështje, 38,5% janë dërguar për gjykim, 21,7% janë pushuar, 35,6% janë pezulluar dhe 4,2% janë transferuar në prokurorinë kompetente. Konkretisht në vitin 2018 janë dërguar në gjykatë 118019 çështje me akuzë ndaj 13414 të pandehurve. Krahimisht me vitin 2017 rezultojnë një rritje prej 2,59% e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 4,65% e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë. Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2018 janë dënuar 10246 të pandehur dhe për 211 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm. Sa i përket treguesve statistikore, për vitin 2018, rezultojnë se janë regjistruar 41 procedime për veprën penale që parashikon nenin 333/a, "Grupi i strukturuar kriminal", ndërkohë 6 procedime penale janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2017 me rritje rreth 2,5 herë të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale. Sa i përket "Trafikimit të armëve dhe municionit" të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal, në vitin 2018 janë regjistru-

Të dhëna shqetësuese paraqet raporti i prokurorisë për vitin 2018 sa i përket disa veprave penale si shkaktimi i vetëvrasjes apo krimet seksuale. Kështu nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 90,73% e procedimeve të regjistruara në vitin 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal "Shkaktimi i vetëvrasjes", në krahim me vitin 2017. Ndërkohë që një veprë



tjetër që paraqitet shqetësuese në këtë raport është krimi seksual. Sa i përket peshës specifike që zë kjo

veprë penale në grupin e veprave penale "Krimet seksuale" është 45,13% për vitin 2018, ndërkohë që në vitin 2017 ka qenë 35,3%. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi krahasuar me vitin 2017. Ndërkohë që në vitin 2018, në grupin e krimeve seksuale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal "Ngacimi seksual", prej 41,67% në krahim me vitin 2017.

## Rriten veprat penale të shkakimit të vetëvrasjes dhe krimet seksuale

1094 po aq sa edhe në vitin 2017. Në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme thuhet se përqindjen më të ulët të kriminalitetit e ka qarku Dibër ndërsa përqindjen më të lartë qarku Vlorë. Sa i përket tendencës, vërehet se rritjen më të lartë për vitin 2018 e kanë qarku Durrës e qarku Fier, ndërsa uljet e kriminalitetit vërehet në qarkun Kukës, qarkun Gjirokastrë e qarkun Berat.

**KRIMINALITETI**

Koeficienti i kriminalitetit për procedimet penale të regjistruara, për 100.000 banorë në vitin 2018 është

1094 po aq sa edhe në vitin 2017. Në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme thuhet se përqindjen më të ulët të kriminalitetit e ka qarku Dibër ndërsa përqindjen më të lartë qarku Vlorë. Sa i përket tendencës, vërehet se rritjen më të lartë për vitin 2018 e kanë qarku Durrës e qarku Fier, ndërsa uljet e kriminalitetit vërehet në qarkun Kukës, qarkun Gjirokastrë e qarkun Berat.

**NJOFTIM ANKANDI**

Shoqëria e Përbarimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të I-rë, për shlyerjen e pasurisë "ARE", me sip. 1045 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 319/24, Vll. 1, Faqe 220, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Sefer Skraqi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me cminin fillestar në vlerën 836.000(teftëqind e trihjetë e gjashtë mijë) LEKË. Ankandi do të zhvillohet me datë 22.05.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.teléfono 042320227, email: elvinh@hotmail.com.

Prokurorja e Përgjithshme, Arta Marku

**PËRGJIMI**

Gjatë vitit 2018 janë ekzekutuar gjithsej 3063 vendime për përgjim të autorizuar nga gjykata në hetimet paraprake, aplikuar në lidhje me 715 procedime penale. Nga këto, 147 procedime penale kanë qenë në kuadër të hetimeve të prokurorisë për krime të rënda. Për sa më sipër është mundësuar interceptimi për 4168 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale. Si rrjedhojë në sajë të kësaj teknike hetimore është arritur në arrestimin ose ndalimin e 619 personave

**TROPOJA ME ULJEN MË TË MADHE TË KRIMIT FIERI ME RITJEN MË TË MADHE**

- Në Berat janë regjistruar 952 procedime, që do të thotë ulje prej 12,74% në krahim me vitin 2017
- Në Dibër janë regjistruar 587 procedime, që do të thotë ulje prej 1,51% në krahim me vitin 2017
- Në Durrës janë regjistruar 2779 procedime, që do të thotë rritje prej 14,69% në krahim me vitin 2017
- Në Elbasan janë regjistruar 2371 procedime, që do të thotë rritje prej 4,27% në krahim me vitin 2017
- Në Fier janë regjistruar 1803 procedime, që do të thotë rritje prej 15,87% në krahim me vitin 2017
- Në Gjirokastrë janë regjistruar 655 procedime, që do të thotë ulje prej 15,37% në krahim me vitin 2017
- Në Kavajë janë regjistruar 528 procedime, që do të thotë ulje prej 14,15% në krahim me vitin 2017
- Në Korçë janë regjistruar 1531 procedime, që do të thotë rritje prej 1,73% në krahim me vitin 2017
- Në Krujë janë regjistruar 719 procedime, që do të thotë rritje prej 12,34% në krahim me vitin 2017
- Në Kukës janë regjistruar 389 procedime, që do të thotë ulje prej 24,47% në krahim me vitin 2017
- Në Kurbin janë regjistruar 450 procedime, që do të thotë ulje prej 15,25% në krahim me vitin 2017
- Në Lezhë janë regjistruar 1177 procedime, që do të thotë rritje prej 13,50% në krahim me vitin 2017
- Në Lushnjë janë regjistruar 849 procedime, që do të thotë ulje prej 2,41% në krahim me vitin 2017
- Në Mat janë regjistruar 166 procedime, që do të thotë ulje prej 9,29% në krahim me vitin 2017
- Në Përmë janë regjistruar 100 procedime, që do të thotë ulje prej 18,03% në krahim me vitin 2017
- Në Pogradec janë regjistruar 507 procedime, që do të thotë rritje prej 5,85% në krahim me vitin 2017
- Në Pukë janë regjistruar 135 procedime, që do të thotë ulje prej 7,53% në krahim me vitin 2017
- Në Sarandë janë regjistruar 951 procedime, që do të thotë rritje prej 2,48% në krahim me vitin 2017
- Në Shkodër janë regjistruar 2166 procedime, që do të thotë rritje prej 9,01% në krahim me vitin 2017
- Në Tiranë janë regjistruar 9867 procedime, që përbëjnë ulje prej 3,89% në krahim me vitin 2017
- Në Tropojë janë regjistruar 200 procedime, që do të thotë ulje prej 25,37% në krahim me vitin 2017
- Në Vlorë janë regjistruar 2297 procedime, që do të thotë ulje prej 1,33% në krahim me vitin 2017

Nga ana e Shoqërisë "Sherbimi Përbarimorë ABP" Shp është shpallur ankandi faza e dyte për pasurinë e mëposhtme:

- 1-"Trruall + Nderëse" me sipërfaqe trruall 5,960 m<sup>2</sup> dhe me sipërfaqe nderëse 502 m<sup>2</sup> me numer pasurie 28/98 regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr.972 date 30.12.2011 e ndodhur në Zonen Kadastrale Nr.8571, Vllumi 15 Faqe 62 me adresë Lushnje. -Çmimi me të cilin fillon ankandi faza e dyte për pasurinë e mesipërme është 616,000 (gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) Euro.
- 2-"Trruall" me sipërfaqe 4,730 m<sup>2</sup> me numer pasurie 28/70 regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr. 973 date 30.12.2011 e ndodhur në Zonen Kadastrale Nr.8571, Vllumi 18 Faqe 143 me adresë Lushnje. -Çmimi me të cilin fillon ankandi faza e dyte për pasurinë e mesipërme është 185,416 (njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) Euro.
- 3-"Trruall + Nderëse" me sipërfaqe trruall 2,400 m<sup>2</sup> dhe me sipërfaqe nderëse 840 m<sup>2</sup> me numer pasurie 28/58 regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr.653 date 25.10.2011 e ndodhur në Zonen Kadastrale Nr.8571, Vllumi 15 Faqe 23 me adresë Lushnje. -Çmimi me të cilin fillon ankandi faza e dyte për pasurinë e mesipërme është 308,350.56 (treqind e tetë mijë e pesëdhjetë pike pesëdhjetë e gjashtë) Euro.
- 4-"Trruall + Nderëse" me sipërfaqe trruall 4,500 m<sup>2</sup> dhe me sipërfaqe nderëse 1,536 m<sup>2</sup> me numer pasurie 28/69 regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr.431 date 21.06.2013 e ndodhur në Zonen Kadastrale Nr.8571, Vllumi 18 Faqe 142 me adresë Lushnje. -Çmimi me të cilin fillon ankandi faza e dyte për pasurinë e mesipërme është 884,800 (tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind) Euro.

Ankandi do të zhvillohet në datë 12.06.2019 në orën 16:00 pranë zyrës së shoqërisë "Sherbimi Përbarimorë ABP" Shp me Përbarues Gjyqësor Privat Admir Beqiri të ndodhur në adresën Rr. Bul Zhan Dark Palli, Kulla 1, Tëpërkopjejtë SHK-1 Kat 4 Ap.10 Tiranë.



**TIRANË** Policia e Tiranës në bashkëpunim me Interpol Tirana dhe me agjencitë e tjera ligjzbatuese arrestuan të shtunën dy persona, njëri i shpallur në kërkim ndërkomëtar për vrasje në Gjermani dhe tjetri i dënuar më parë për trafik droge në Zvicër. Sipas policisë, shtetasi me origjinë kosovare Shkëlqim Kastrati 23-vjeç, i kërkuar për vrasje u arrestua në një palestër, ndërsa në shtëpinë e tij ku jetonte me qira u arrestua edhe një 38-vjeçar, i cili ishte i skeduar nga policia vicerane për shitje të drogave të forta. Kosovari Shkëlqim Kastrati, rezultoi i përfshirë në një tentativë vrasje në dhjetorin e 2017 në një diskotekë në

**Zbulohet foto e 23-vjeçarit dhe e shkuara**

**U kap të shtunën në Tiranë, kush është kosovari i shumëkërkuar**



Donaueschingen në Gjermani. Menjëherë pas ngjarjes i riu u arratis, ndërsa prokuroria nxori 2500 euro si shpërblim për të gjithë personat, të cilët mund të kishin dijeni për të riuin. Ai u kap dje në Tiranë në një palestër dy vite pas arratisjes nga Gjermani ndërsa rrezikon të dënohet me 15 vite burg. Bashkë me dy të arrestuarit dhe drogës së sekuestruar, Policia ka shpallur në kërkim edhe pronarin e shtëpisë ku jetonin personat e mësipërm.

**Nikolli, fitonte zemrat e grave dhe i mashtronte**

**Arrestohet "mjeku" hajdut, jeta e luksit që bënte shqiptari**



Një shqiptar që hiqej si mjek është arrestuar në Itali. Klodian Nikolli, me origjinë shqiptare, hiqej sikur ishte diplomuar për mjekësi në Boconi. Në shkurt ai u vu nën arrest shtëpie dhe menjëherë u zhduk. Pas tre muajve në arrati, ndoshta duke bastisur sërish shtëpitë e italianëve, u arrestua përsëri. Në shtëpinë e tij, Nikolli shfaqti një jetesë luksoze, piktura të shekullit të njëzetë, unaza diamante etj. Të

gjitha gjërat e vjedhura nga shtëpitë e Milanos, ku ai kishte ardhur me mjeshtëri të një hajduti, të formës fizike dhe me pamjen e tij mjaft tërheqëse i veshur bukur dhe mjaft i sjellshëm sidomos me femrat ku shumë prej tyre u dashuruan pas tij. Pas një ndjekjeje të lodhshme nga ana e policisë është bërë i mundur edhe ndalimi i tij në Milano.

Në Peqin kapen telefona celularë në pajisjet elektro-shtëpiake

# Gëlltiti 22 doza droge, eko-ja zbulon të burgosurin

*I riu u kthye në qeli pas lejes shpërblyese*

**KORÇË**

Një i dënuar në burgun e Korçës u konstatua se kishte futur 22 doza narkotike brenda ambienteve ku vuante dënimin. Ai u zbulua pas kryerjes së ekografisë, e cila verifikoi se i dënuari me iniciale B.L kishte gëlltitur në stomakun e tij plot 22 doza, sasi të cilën e kishte futur në qese plastike tekta po kthehej nga leja shpërblyese. Pasi u krye ekografia u konstatua se në stomak ka edhe doza të tjera. Një tjetër rast është goditur edhe në burgun e Peqinit, ku të dënuarit kishin fshehur 4 telefona celularë në pajisjet elektro-shtëpiake. Veç masave të menjëhershme të ndërmarra nga autoritetet e burgut, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje dhe Policia e Shtetit, po kryejnë veprimet procedurale dhe hetimore për veprën penale të "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal dhe "Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim" parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal. Në po këtë datë, në vijim të kontrolleve në sistemin penitenciar nga ana e Policisë së Burgjeve, në IEVP Peqin, u krye kontroll në disa qeli në sektorin e sigurisë së lartë dhe u gjetën 4 aparate celularë të fshehu-



**RASTI**

Një tjetër rast është goditur edhe në burgun e Peqinit, ku të dënuarit kishin fshehur 4 telefona celularë në pajisjet elektro-shtëpiake. Veç masave të menjëhershme të ndërmarra nga autoritetet e burgut, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje dhe Policia e Shtetit, po kryejnë veprimet procedurale dhe hetimore për veprën penale të "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Në vijim të kontrolleve në sistemin penitenciar nga ana e Policisë së Burgjeve, në IEVP Peqin, u krye kontroll në disa qeli në sektorin e sigurisë së lartë dhe u gjetën 4 aparate celularë të fshehura në pajisjet elektro-shtëpiake të të dënuarve D. H dhe E. H.

**Arrestohet shkodrani ishte në kërkim**

Policia e Shkodrës ka arrestuar sot një 30-vjeçar të shpallur në kërkim për prodhim të lëndëve narkotike, ndërsa gjykata kishte dhënë dënim në mungesë për të me 5 vite burg. Pas një pune të mirorganizuar u kap dhe u ndalua shtetasi i shpallur në kërkim Valentin Gjeloshi, 30 vjeç, banues në lagjen "Skënderbeg", Shkodër, Kapja dhe ndalimi i tij u bë pasi Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e formës së prerë Nr:98, datë 13.03.2019, e ka dënuar me 5 vite burgim për veprën penale "Prodhim dhe shitja e narkotikëve", e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 283/3 i Kodit Penal.



ra në pajisjet elektro-shtëpiake të të dënuarve D. H dhe E. H. Pas masave të menjëhershme të ndërmarra nga autoritetet e IEVP-së, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje po kryen veprimet e para procedurale dhe hetimore për zbardhjen dhe dokumentimin për veprën penale të "Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim" parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal"-njofton policia.

## PENSIONET E PLEQËRISË NDRYSHIMET

Aplikimi për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2018 e në vazhdim

# Vendimi i qeverisë: Koeficientët e rinj për pensionet e pleqërisë

ISSH rillogaritje masës së pensioneve, kategoritë që preken

Voltiza Duro

Të gjithë të moshuarit në mbarë vendin, mund të njihen me koeficientin e ri të indeksimit, në mënyrë që të mund të përllorarisin masën e pensionit që u takon për vitet e punës me kontribute. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot vendimin më të fundit të qeverisë mbi miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar: "Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, paragrafi i dytë, dhe 59, pika 1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave vendosi që koeficienti i indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2017, për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensionit, të jetë 3,7 për qind", thuhet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Në këtë të fundit theksohet se për efekt të llogaritjes së masës fillestare të pensioneve, me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar, të miratuar me vendimin nr.571, shtohen edhe me koeficientin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi. "Në vitin 2019, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2018, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë nuk mund të jenë më të larta se: a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 26 000 lekësh, e përcaktuar në vendimin nr.809, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001; b) paga maksimale në shkallë vendi, prej 114 670 lekësh, e përcaktuar sipas kriterëve të paragrafit të fundit të nenit nr.10, të ligjit nr.7703, datë 1.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim", theksohet në vendimin e qeverisë.



### RILLOGARITJA

Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të bëjë rillogaritjen e masës së pensioneve për të moshuarit që aktualisht kanë dalë në pension por që iu janë llogaritur masat me koeficientë më të ulët. Kështu pensionet që janë lidhur e që do të lidhen në vazhdim do të shumëzohen me koeficientin 8,76.

## 1994

### VITI, LLOGARITJA

Pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicion pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indeksohet e del vlerë më e lartë.

## 2018

### KOEFICIENTËT

Në vitin 2018-të, hyri në fuqi një vendim i Këshillit të Ministrave, që preku të gjithë pensionistët e dalë në pension nga 1 janari i vitit 2018 e në vazhdim. Ndërkohë Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të bëjë rillogaritjen e masës së pensioneve për të moshuarit që aktualisht kanë dalë në pension por që iu janë llogaritur masat me koeficientë më të ulët.

Ndërkohë, efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, dhe përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Sakaq, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bazuar në vendimin nr.571, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për koeficientët e indeksimit të pagave për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", dhe në këtë vendim, harton e shpall tabelën e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar për periudhën deri në vitin 1994 dhe

për vitet në vazhdim, deri në vitin 2019, dhe ngarkohet për zbatimin e tyre.

### RILLOGARITJA

Në vitin 2018-të, hyri në fuqi një vendim i Këshillit të Ministrave, i propozuar fillimisht nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë që preku të gjithë pensionistët e dalë në pension nga 1 janari i vitit 2018 e në vazhdim. Ndërkohë Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të bëjë rillogaritjen e masës së pensioneve për të moshuarit që aktualisht kanë dalë në pension por që iu janë llogaritur masat me koeficientë më të ulët. Kështu pensionet që janë lidhur e që do të lidhen në vazhdim do të shumëzohen me koeficientin 8,76. Në vitin 2018, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve sho-

qërore deri në vitin 2017, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë të përcaktuar në këtë vendim nuk mund të jenë më të larta se trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2018, për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001. Ky vendim vlen edhe për vitin 2019-të, ku koeficienti do të jetë 1,00, njësoj si në 2018-ën. Ndërkohë pagat nuk mund të jenë më të larta se paga maksimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2018, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim. "Efektet finan-



### KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE

Për pagat referuese deri më 1.1.1994	8.76;
Për pagat e vitit	1994 8.76;
Për pagat e vitit	1995 7.05;
Për pagat e vitit	1996 5.47;
Për pagat e vitit	1997 5.47;
Për pagat e vitit	1998 4.57;
Për pagat e vitit	1999 3.71;
Për pagat e vitit	2000 3.38;
Për pagat e vitit	2001 2.89;
Për pagat e vitit	2002 2.67;
Për pagat e vitit	2003 2.39;
Për pagat e vitit	2004 2.17;
Për pagat e vitit	2005 1.97;
Për pagat e vitit	2006 1.79;
Për pagat e vitit	2007 1.71;
Për pagat e vitit	2008 1.51;
Për pagat e vitit	2009 1.39;
Për pagat e vitit	2010 1.33;
Për pagat e vitit	2011 1.28;
Për pagat e vitit	2012 1.23;
Për pagat e vitit	2013 1.18;
Për pagat e vitit	2014 1.18;
Për pagat e vitit	2015 1.02;
Për pagat e vitit	2016 1.02;
Për pagat e vitit	2017 1.00;
Për pagat e vitit	2018 1.00;
Për pagat e vitit	2019 1.00

ciare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2018 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxheteve vjetore, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore", nënvizohet në vendimin e qeverisë.

### KOEFICIENTËT

Koeficientët e indeksimit janë ata koeficientë që kërkojnë që pagën mbi të cilën janë paguar kontrib-

utet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra ti heqin efektin "gërryes" të inflacionit. Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar në 94-ën, me gjithë indeksat e ndryshimit që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë, indeksohet sot me një koeficient. Edhe ky indeks është i përshkallëzuar, e fillojnë nga 94' deri në momentin që del në pension. Viti 2018 nuk ka indeks, kurse viti 2014, 2015 kanë koeficientët respektivë.





Tabela me dokumentacionin e plotë që duhet të dorëzojnë të moshuarit

# Formula, si të llogarisni saktë masën e pensionit që ju takon

*Si veprohet për kontributet e paguara deri në 1994-ën*

Voltiza Duro

**F**ormula e përlllogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individi ka paguar kontributet. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën, pa ndërprerje, pra ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti '75' kur individi ka filluar punë për herë të parë, deri në 2018-ën me pagat që ai ka gëzuar. Këto paga referuese i shërbejnë individit nga dita që ka filluar punë deri në 31 dhjetor të 1993-it e këto paga kanë koeficientët e vet të indeksimit. Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi në ish-kooperativë bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit, si ish-punonjës i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomiksht aktiv pas datës 01.01.1994. Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 01.01.1994 si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8.59. Për llogaritjen e pensionit përdoret formula:  $PP$  (Pensioni i pleqërisë) =  $PS$  (Pension Social) \* (shumëzuar) vjetërsi kontributive të realizuara / vjetërsi kontributive që kërkohet + 1/100\* (shumëzuar) vite sigurimi\* (shumëzuar) BV ( baza e vlerësuar).



**BAZA E VLERËSUAR**  
Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit.

Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomiksht aktiv pas datës 01.01.1994.

## DOKUMENTACIONI

Individi që mendon se mund të përfitojë pension pleqërie duhet të bazohet te kriteret, moshë dhe vitet me kontribute. Domosdoshmërisht duhet të ketë dokumentin që vërteton moshën, e cila duhet të jetë mbi 60 vjeç e 8 muaj për gratë e mbi 65 për burrat. Tashmë është më e thjeshtë për ta verifikuar vërtetësinë e moshës, pasi vetë ISSH ka akese mbi regjistrin themeltar të shtetasve. Megjithatë, qytetari duhet të dorëzojë një fotokopje të kartës së identitetit, e në rastet kur pretendon të marrë kompensime të tjera që i bashkëngjiten pensionit, duhet të dorëzojë edhe dokumente të tjera si certifikata familjare për të verifikuar pjesëtarët e familjes. Kur individi mendon se ka 40 vite punë, duhet të paraqesë librezën e punës dhe dokumentin që vërteton pagat që ka marrë nga 1 janari i 1994 e deri më sot. Për të gjithë ata që kanë punuar pas 1 janarit të vitit 1994 e deri më sot,

listpagesat janë grumbulluar në arkivin e sistemit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore që funksionon edhe sot. Ndërsa për periudhat kur individi ka punuar para vitit 1994, shërben librezë e punës dhe nuk është e nevojshme të sjellë vërtetime page. Kur individi humb librezën e punës, ai duhet të paraqitet pranë ISSH-së, madje edhe në rastet që ende vazhdon të punojë me kontribute. Në këtë rast, personi bën një kërkesë deklarative në të cilën jepet të dhënat individuale të personit, paraqitet historiku i të gjitha punëve që ka bërë i siguruar. Dhe pas kësaj duhet të shpjegojë që vetë personi të fjalë kërkon të pajiset me një dokument të ri ku të konfirmohen të gjitha vitet e punës që individi ka kryer. Organet e sigurimeve shoqërore, janë të detyruara ta marrin kërkesën deklarative dhe të vënë në dijeni qytetarin që duhet të presë jo më shumë se 60 ditë, derisa të bëhen të gjitha verifikimet e nevojshme mbi të gjitha punët që ka bërë personi. Dokumenti, pra librezë e punës mund të vlerësohet si e pasaktë në ato raste kur ka ndërhyrje, falsifikim datash, korrigjime vullash apo dublikatë librezë. Në momentin kur ka dublikatë të librezës së punës me siguri ka një "ngërc" e menjëherë duhet të verifikojë regjistrat themeltarë, borderotë, apo listpagesat që të vërtetojnë faktin që individi ka qenë realisht në marrëdhënie pune.

## DOKUMENTACIONI:

- ▶ Fotokopje e kartës së identitetit;
- ▶ Certifikatë e gjendjes familjare;
- ▶ Certifikatë martesë (vetëm për aplikueset femra);
- ▶ Vërtetim nga Komuna/Bashkia për ndryshimin e gjeneralitetit;
- ▶ Vërtetim nga qendra e fundit e punës për gjeneralitetin.
- ▶ Kur kërkohet pension si nënë me shumë fëmijë dhe në certifikatën familjare nuk figurojnë të gjithë fëmijët, duhet të paraqitet edhe certifikatë e veçantë lindjeje, martesë ose vdekjeje, për fëmijët që nuk figurojnë në certifikatën e gjendjes familjare;
- ▶ Dy copë fotografi.
- a) Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës janë:
  - ▶ Librezë e punës;
  - ▶ Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj;
  - ▶ Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore;
  - ▶ Vendim gjykate për njohje të vjetërsisë në punë (në se shikohet e arsyeshme);
  - ▶ Vërtetim i Degës Ushtrake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuessit meshkuj);
  - ▶ Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët;
  - ▶ Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë për kërkuesset femra (kur kanë mbaruar studimet e larta, me shkëputje nga puna).
- b) Për personat që përfitojnë nga Ligji nr. 7514, datë 30.09.1991 "Për pajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë" duhen edhe:
  - ▶ Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
  - ▶ Vërtetim për kohën e vuajtjes së dënimit, lëshuar nga Ministria e Rendit Publik;
  - ▶ Vërtetim për faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij, të lëshuar nga Komisioni i Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Drejtësisë;
  - ▶ Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qenien në punë.
- c) Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:
  - ▶ Vërtetim page, sipas së cilës është dërdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip (nëse ka punuar dhe ka dërdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994);
  - ▶ Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose dërdhjen e periudhave kontributive.

# Foto e rrallë, Edi Rama 5 muajsh në studion e skulptorit të famshëm, ku nuk ka shkelur më prej 55 vjetësh?!

*Intervista ekskluzive e prof. Muntaz Dhramit në emisionin "Rrëfim", për miqësinë e ngushtë me Kristaq Ramën dhe rezervat për dy djemtë e tij, Edin dhe Olsin*

**E**dhe pse si kudo në botë dhe ashtu edhe në Shqipëri personazhet e njohur VIP dhe politikanët në përgjithësi mundohen që ta mbajnë të fshehtë të kaluarën e tyre dhe jetën private, duke e mbajtur atë larg syve dhe vëmendjes së publikut të gjerë, ata nuk mund t'i shpëtojnë gjithmonë asaj. Kështu në media të shkruara dhe vizive herë pas here janë bërë publike jo vetëm "detaje të fshehta" nga e kaluara dhe jeta private e këtyre personazheve, por kanë dalë dhe janë publikuar edhe foto të ndryshme të tyre nga persona të tjerë, miq, të afërm, familjarë, të njohur apo bashkëpunëtorë të tyre. Një nga këto "altare" ku këta personazhe tregojnë dhe bëjnë publike jo vetëm të fshehtat e jetës së tyre, por edhe të miqve, kolegeve dhe të njohurve, është dhe emisioni RREFIM në TV Scan, i moderuar nga gazetarja, Albana Shehu Qirjako dhe me autor, gazetarin dhe studiuesin e njohur, Dashnor Kaloçi. Kështu ka ndodhur së fundmi edhe me kryeministrin tonë, Edi Rama, me këtë foto të rrallë që "Gazeta Shqiptare" e publikon për herë të parë për lexuesin e saj, e cila është marrë nga emisioni në fjalë "RREFIM" i TV Scan, ku i ftuari i radhës ka



Edi Rama 5-muajsh në studion e Muntaz Dhramit



Kristaq Rama në dasmën e Muntazit

gun e tij të ndierë, Kristaqin, për të cilin Muntazi ruan ende respekt dhe kujtim të mira, gjë e cila veç të tjerash e tregon edhe busti që ai ka realizuar, për dy djemtë e tij, Edin dhe Olsin, prof. Muntazi duket se ka shumë rezervë dhe hatërmbetje, pasi ata nuk duan t'ia dinë për shokun dhe kolegun e babait të tyre. Këtë gjë e konfirmon vetë prof. Muntazi në emisionin "RREFIM", ku shprehet se: "Edi Rama, që nga ajo ditë kur ai ka qenë fare i vogël, vetëm pesë muajsh, të cilin e shikoni te kjo foto në krahët e së emës, Anetës, foto që na e ka bërë mikun dhe kolegun im, Kristaqi, ai (Edi) nuk ka ardhur më kurrë në studion time". Po të njëjtën vërejtje ai ka edhe për Olsin, për të cilin shprehet: "Edhe Olsit i pata thënë të vinte në studion time dhe të shikonte bustin e Kristaqit që unë kam realizuar, por ai nuk ka ardhur as sot e kësaj dite.....?". Por rezervat e Muntaz Dhramit duket se nuk janë vetëm

në planin personal dhe miqësor, pasi ai në rrëfimin e tij ka shprehur edhe disa kritika të forta që kanë të bëjnë me artin e kulturën, e kryesisht me veprat e artit në skulpturë, të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës së qeverisjes së Partisë Socialiste dhe që në një farë mënyre indirekt bëjnë përgjegjës edhe kryeministrin Edi Rama. Si p.sh. problemi i monumentit të Adem Jasharit që ndodhet në fillim të Rrugës së Durrësit, vepër e cila është realizuar nga prof. Muntazi disa vjet më parë. Ai monument prej disa kohësh është zhvendosur nga bazamenti i tij fillestar dhe është futur në një shtatërvan me ujë, gjë e cila e ka mërzhitur jashtë mase mjeshtrin e madh të skulpturës, madje e ka tronditur rëndë dhe nuk ka dashur ta besonte kur ia kanë treguar deri sa e ka parë me sytë e tij se ku kishte përfunduar monumenti. Lidhur me këtë, në emisionin "RREFIM", ai shpre-

het: "Është një veprim i papërgjegjshëm, madje skandaloz. Nuk gjen tjetër rast të tillë në botë që një monument ta ketë bazamentin (pëdestalin) në ujë, siç ka ndodhur me atë të Adem Jasharit. Shkova menjëherë dhe takova ata që kishin urdhëruar për këtë gjë, duke u thënë se: si nuk keni marrë mundimin të më pyesnit edhe mua si autor i tij?! Dhe përgjigja e tyre ishte: Nuk të kemi gjetur dot?! Ça t'iu thosha, unë jam nga mëngjesi në darkë vonë në studion time?! Po kështu prof. Muntazi në emisionin "RREFIM" u shpreh ashpër edhe për veprimin që është bërë me Qendrën Kombëtare të Realizimit të Veprave të Artit, të cilën prej disa kohësh e kanë kthyer në varësi vetëm të Tiranës. Lidhur me këtë, prof. u shpreh: "Si mund të bëhet kjo, është e pafalshme ajo gjë që ka ndodhur. Ajo Qendër duhet të mbetet Kombëtare sikur ka qenë, pasi as Tropoja dhe as Gjirokastra, p.sh. nuk kanë mundësi, fonde dhe mjete financiare e njerëz të specializuar, për të mirëmbajtur veprat e artit që janë në bronz. E shumta që ata mund të bëjnë është t'u japin atyre veprave ndonjë dorë varak me ndonjë bojaxhi, asgjë tjetër nuk mund të bëjnë ata. Po pse kështu bëhet?! Mjeshtri i madh i skulpturës shqiptare, i vlerësuar jo vetëm para viteve '90-të si një nga autorët realizues të disa prej veprave të artit më në zë, (disa me bashkautor), si p.sh. monumenti i Kristoforidhit në Elbasan, monumenti Pavarësisë në Vlorë, monumenti Nënë Shqipëri, monumenti i Drashovicës, reliefi i Kryeministrisë, Monumenti i Pezës, monumenti i Enver Hoxhës në Gjirokastër,

etj. etj., ka vazhduar të punojë edhe pas viteve '90-të, duke realizuar një sërë veprash. Si p.sh. monumenti i Ali Pashë Tepelenës në Tepelenë, monumentet e Lasgush Poradecit dhe Mitrush Kutelit në qytetin e Pogradecit, monumenti i Adem Jasharit në Tiranë etj. etj., të gjitha të fituara me konkurse. Dhe vazhdon të punojë përsëri edhe pse mbi supë mban plot 83 vjet të jetës së tij. Prof. Muntazi punon çdo ditë në studion e tij nga mëngjesi në orët e vona të mbrëmjes dhe së fundi ka në përfundim një monument të Baba Ali Tomorrit, klerikut të famshëm bektashi, monument që pas derdhjes në bronz do të vendoset në malin e shenjtë të Tomorrit që është një qendër peligrinazhi dhe çdo muaj gusht vizitohet nga mijëra e mijëra besimtarë. Madje lidhur me këtë gjë, në emisionin RREFIM, prof. Muntazi tregoi edhe një episod të ndodhur para disa ditësh kur teksa punonte në studion e tij me atë monument, nga tavani i lartë i studios (mbi 10 metra) së amortizuar u shkëput një dërrasë e madhe e cila i ra mbi monumentin prej balte, duke u bërë copa-copa, por atë vetë nuk e preku asnjë ashtëllë opë copë dërrase, pasi e mbrojti një dërrasë tjetër që ai e kishte venë si skelë. Atë gjë prof. Muntazi e konsideron si një mrekulli dhe jetën ia dedikon vetëm njeriut të shenjtë baba Ali Tomorrit. Por ajo që të bie në sy dhe nuk është prekur fare në emisionin RREFIM, është fakti i çuditshëm që prof. Muntaz Dhrami nuk mban titullin "Mjeshtër i madh", të cilin e mbajnë edhe disa nga nxënësit e tij, apo të tjerë emra fare anonim?! TV Scan



Skulptori Muntaz Dhrami në 1968 duke punuar bustin e Shkurte Pal Vates



Skulptori Muntaz Dhrami duke vizituar aeroportin e Parisit

sideratat për ish-mikun dhe kole-



# Ambasadorët të impresionuar me birrën "Korça"

*Shtatë diplomatë të huaj nga Maqedonia e Veriut zgjodhën të vizitojnë ambientet e birrës së parë shqiptare*

Fabrika e birrës "Korça" është kthyer në magnet për vizitorët e huaj. Kësaj radhe ambasadorë nga Maqedonia e Veriut dhe një grup turistësh gjermanë shijuan të sapo prodhuar birrën e parë shqiptare. Shijen e saj e krahasojnë me birrën në vendet e tyre.

Shtatë ambasadorë të huaj nga Maqedonia e Veriut zgjodhën të vizitojnë këtë fundjavë ambientet e birrës së parë shqiptare, birrës "Korça". Diplomatët kanë parë nga afër investimin gjigant duke u impresionuar jo vetëm nga fabrika, por edhe nga shija e birrës së freskët të cilën nuk hezituan ta quanin birrën më të mirë shqiptare.

Ambasadori shqiptar në Maqedoninë e Veriut, Fatos Reka thotë se birra "Korça" është simbol që konkurron me sukses jo vetëm në tregun vendas, por edhe në atë ndërkombëtar. Ambasadori çek Miroslav Toman thotë se fabrika e birrës "Korça" me teknologji çeke prodhon birrë cilësore.

"Jam mirënjohës që pronari, zoti Irfan Hysenbelliu, ka zgjedhur teknologjinë çeke për këtë fabrikë që është shumë e njohur në Shqipëri. Vendi im Çekia, është e njohur për prodhimin shumë cilësor të birrës. Nuk e prisja që një birrë kaq e mirë mund të provohet edhe në Shqipëri. Do jetë pa diskutim zgjedhja ime, pa diskutim do zgjedh birrën "Korça". Provova birrën bionde dhe të zezë madje dhe i përzeva ato dhe mendoj se duhen vlerësuar të dyja nga konsumatorët."

Një tjetër ambasadorë po aq e impresionuar nga fabrika dhe birra "Korça" është ambasadorja japoneze në Maqedoninë e Veriut, Keiko Haneda. "Sot ne provuam diçka shumë të veçantë nga birraria këtu, birrën e freskët, ndaj m'u krijua ndjesia se këtu përpiqen të ndërthurin tradicionale me tekniken moderne, por shija është shumë e freskët dhe mendoj se ata po përpiqen të prodhojnë birrën më të mirë në vend".

Në fundjavë fabrika e birrës "Korça" është vizituar edhe nga një grup turistësh gjermanë. Ata provuan shijen e mrekullueshme të birrës së sapo prodhuar dhe gatimet tradicionale të restorantit në një atmosferë të ngrohtë miqësore.

Restaurimi dhe vjetërsia e fabrikës ngjalli shumë kureshtje tek turistët, të cilët dëgjuan me vëmendje historikun e saj. Shprehen se kanë mbetur të impresionuar nga vizita dhe shijen e birrës së parë shqiptare e krahasojnë me atë gjermane.

"Ne vijmë nga Mynihu, më duket interesante vizita. Kjo fabrikë është shumë e vizituar dhe birra "Korça" një nga birrat më të njohura.

Duke qenë se ne kemi shumë fabrika birre mund të them se këtu në Shqipëri gjetëm një fabrikë birre, gjithashtu, shumë të mirë, një prodhim të veçantë. Për mua birra është shumë e mirë, më pëlqen shumë birra e zezë e adhuroj"

"Mund të them që ishte e shkëlqyeshme, ishte gjithashtu, një



Diplomatët e huaj duke shijuar birrën Korça



vizitë dhe një guidë brenda fabrikës, tani që po e pi, po më shijon vërtet. Birra është e shkëlqyeshme. Jam e surprizuar se sa e

vjetër është kjo fabrikë që vazhdon të jetë në punë dhe për restaurimin është bërë një punë fantastike. Birra po më shijon shumë do

ishte shumë interesante për mua të shijja edhe muzeun e kësaj birrarie në të ardhmen".

Gotat e mbushura me birrë dhe

entuziazmi i turistëve krijuan një atmosferë gjallëruese në hollin e fabrikës teksa uruan me gotat e tyre.



Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, shpërndahen tapitë dhe paratë e kompensimit

Ornela Manjani

Rreth 2 mijë persona që kanë ndërtuar pa leje do të marrin tapitë për truallin. Ndërkohë, 510 pronarëve të cilëve u është zënë toka nga këto ndërtime do të kompensohen. Vlera e parave që do të përndahet për përfituesit është rreth 230 milionë lekë. Vendimi është marrë këtë të mërkurë nga qeveria dhe do të zbatohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila do të pajisë me certifikatë pronësie 2 mijë përfituesit në 12 qarqe të vendit. Ndërkohë që fondi prej 230 milionë lekësh do të shpërndahet nga Agjencia e Trajtimit të Pronave. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e tapive dhe sipërfaqet takuese për secilin dhe

# VKM, lista me 2 mijë pronarët që marrin tapitë

## Kompensohen pronarët, 230 milionë lekë për 510 përfitues

listën me pronarët që kompensohen së bashku me shumën e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

### VENDIMI

Qeveria miratoi kalimin e së drejtës së pronësisë në favor të subjekteve për-

fituese për 1 205 parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre, ku përfitojnë rreth 2 mijë familje. Përfituesit janë në qarkun

Berat, Qarkun Elbasan, Qarkun Durrës, Qarkun Tiranë, Qarkun Fier, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Kukës dhe Korçë. Sipas vendimit të qeverisë, masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të

paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas ZVRPP-së është 33 964,81 m<sup>2</sup> dhe vlera totale e kompensimit financiar është 229 092 338 lekë. Qeveria ngarkon zyrat ven-

dore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, Elbasan, Librazhd, Durrës, Tiranë, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Kavajë dhe Kukës të regjistrojnë brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to, në përputhje me përcaktimet e pikave 15 e 16, të vendimit nr.1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALU-IZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara".

Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë			Sipërfaqja për
	Emër	Atësi	Mbiemër	
1	2	3	4	5
<b>QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA</b>				
599	NAFIE	RUSTEM	GURI	197.37
	HAIR	QENAM	GURI	
<b>QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA</b>				
600	GJERGJ	MARK	NIKOLLI	306
601	GENC	GJON	NIKOLLI	217
<b>QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA</b>				
602	GJELINE	PREND	PERGEGA	260
603	ILIRJAN	FEIM	MUCOLLARI	204.98
<b>QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA</b>				
604	ZEF	NIKOLL	TOMA	241.19
<b>QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA</b>				
605	JOSIF	PAL	BARDHI	415
<b>QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA</b>				
606	DODE	FRROK	ZEFI	252.5
<b>QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA</b>				
607	SOKOL	JAK	TUSHI	393
<b>QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA</b>				
608	ILIR	DEMIR	JONUZI	230.58
609	MARIE	PJETER	PRENGA	80.3
610	FERDINAN	ZEF	DODA	22.95
<b>QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA</b>				
611	PAL	NDREC	NDRECA	319.38
<b>DREJTORIA E ALUIZNI-T KUKËS</b>				
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP HAS, ZONA KADASTRALE</b>				
612	REXH	ADEM	CAHANI	500
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP TROPOJË, ZONA</b>				
613	YLLI	NDOC	PJETERNIKAJ	300.07
614	YLLI	NDOC	PJETERNIKAJ	144.38
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
615	KOMUNT	MYSLIMAN	SHQIPTAR	280
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP HAS, ZONA KADASTRALE</b>				
616	AVNI	DELI	MAZRREKU	461.27
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP TROPOJË, ZONA</b>				
617	IMER	AVDYL	SYLAJ	377.1
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
618	ISA	SALI	DOBRUSHI	97.02
619	ISA	SALI	DOBRUSHI	311.92
620	ISA	SALI	DOBRUSHI	499.38
621	ISA	SALI	DOBRUSHI	306.6
622	RAMIZ	ALI	VOKA	292
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP TROPOJË, ZONA</b>				
623	ADRIATI	ADEM	RROGAMI	500
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP HAS, ZONA KADASTRALE</b>				
624	SHKELZE	QAMIL	SHETA	500
625	FATMIR	NUHARREM	DAUTI	396
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA KADASTRALE</b>				
626	SAFET	NEZIR	SELIMAJ	83.21

Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë			Sipërfaqja për
	Emër	Atësi	Mbiemër	
1	2	3	4	5
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP HAS, ZONA KADASTRALE</b>				
627	YLBER	MUSTAF	XHAFA	339
628	URIM	SELIM	LUSHI	263
629	AGIM	SADIK	LUSHI	379
630	NEZIR	SADIK	LUSHI	119
631	NEZIR	SADIK	LUSHI	483
632	GËZIM	ZEQIR	KURTI	260
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
633	SHAQIR	XHEMAL	SHAQIRI	331.35
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP HAS, ZONA KADASTRALE</b>				
634	ASTRIT	BAJRAM	ÇUNI	147
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP TROPOJË, ZONA</b>				
635	PROVINC	FRANÇESKA	SHQIPTARE	500.00
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP HAS, ZONA KADASTRALE</b>				
636	NAIM	REXHEP	DAUTAJ	424
637	SADIK	QAZIM	JAKU	389
638	FATMIR	REXHEP	DAUTI	298
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
639	SHPEND	RAMIZ	ELEZAJ	331.62
640	HAFIZ	EJUP	ELEZI	211.99
641	MELEQË	ZEJNEL	XHAHU	291.57
642	SHPRESIM	XHELAL	SHEHU	13.61
	PETRI	DERVISH	METAJ	
643	SHUKRI	IMER	NERGUTI	281.29
644	VARUZH	VAHRAMI	PIRANJANI	45.34
	EDUAR	FEJZI	SHIMA	
	START	PLUS	SH.P.K.	
	PLUTON	INVESTOR	SH.P.K.	
645	TRANA	REAL	CAPITAL	
645	QEMAL	SADIK	HAZIRAJ	
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
646	NAIM	RAMIZ	DOGJANI	291.92
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
647	MALIQ	ILJAZ	GERMIZI	404.73
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
648	ERJON	TEKI	NERGUTI	376.15
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP HAS, ZONA KADASTRALE</b>				
649	GËZIM	REXH	KOKA	358
650	ILIR	AHMET	KOKA	268
651	GEZIM	AHMET	KOKA	295
652	ARTAN	RASIM	KURPALI	329
653	BILBIL	ISA	KURPALI	462
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
654	ILMI	ZENEL	CENAJ	293.80
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
655	BYLBIL	ILJAZ	MUJA	402.03
656	ILJAZ	KAMER	SHEHU	377.70

Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë			Sipërfaqja për
	Emër	Atësi	Mbiemër	
1	2	3	4	5
657	KUJTIM	MAHMUT	BASHA	295.23
658	BAFTJA	MALË	HALLAJ	380.76
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP HAS, ZONA KADASTRALE</b>				
659	BESIM	REXHEP	SHURBI	360
660	LINDITA	ALI	CENALIA	405
	ERVIN	ISMET	CENALIA	
	ARBER	ISMET	CENALIA	
	ISMA	ISMET	CENALIA	
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
661	KUJTIM	VEHAP	ONUZI	96.23
662	PETRIT	HYSNI	ONUZI	250.98
663	ILMI	HYSNI	ONUZI	269.85
664	HAKI	IDRIZ	ONUZI	306.42
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP HAS, ZONA KADASTRALE</b>				
665	ARMIR	AVDI	SHURBI	396.25
<b>QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS, ZONA</b>				
666	JEMIN	BAJRAM	ISEBERI	15.94
667	RUKJE	HALIT	CENAJ	385.69
668	KISMET	REXHEP	ELEZI	46.69
<b>DREJTORIA E ALUIZNI-T KORÇË</b>				
<b>QARKU KORÇË, ZVRPP POGRADEC, ZONA KADAS</b>				
669	ÇELNIK	SHEFKI	KAPRI	281
670	KRISTO	HAXHI	PERE	151.5
<b>QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA</b>				
671	ZUA	REXHEP	DOKO	475.8
<b>QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA</b>				
672	VASIL	VANGJO	DHIMITRI	9.5
<b>QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA</b>				
673	PRANVER	RUSHIT	BEGOLLI	18.4
	HYSEN	BEKTASH	DIKOLLI	
674	KLEMENTI	AMIT	PASHOLLARI	367
675	HASAN	GARIP	JONUSLLARI	327.4
<b>QARKU KORÇË, ZVRPP POGRADEC, ZONA KADAS</b>				
676	MITAT	KADRI	CANI	318
<b>QARKU KORÇË, ZVRPP POGRADEC, ZONA KADAS</b>				
678	VASIL	LYTFI	ÇORBAXHIU	566.6
<b>QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA</b>				
679	SOTIR	KADRI	METKO	54
680	MYRVE	QANI	PAZAJ	104.5
681	Dhimitri	Ligor	Vanko	28.3
	Sofika	Thoma	Vanko	
<b>QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA</b>				
682	RIZA	ZEQIR	SHAHOLLI	374
				137.8



QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA				
683	PELLUMB	SOTIR	GJINI	294
QARKU KORÇË, ZVRPP POGRADEC, ZONA KADA				
684	SKENDE R	MYFTAR	KOLGEGA	348
687	BASHKI	FETI	BEGA	353.1
688	BAJRA	MYSKE	NURÇELLARI	107.5
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA				
689	ELIDJON	SADIK	LAKO	161.1
690	ALKE	VALTER	BRAHIMLLA R	198.95
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA				
692	HYSEN	AVDULLA	MUÇOLLARI	56
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA				
693	FILLOR	FAIK	KOÇLLARI	300
694	MYQERE	GANI	BASHLLARI	370.8
695	VALMIRA	SHYQYRI	(KUPE)HOXHA	319.8
	FLORANT	SHYQYRI	HOXHALLARI	
	ZHULIETA	SHYQYRI	HOXHALLARI	
	THEODHO	SHYQYRI	HOXHALLARI	
	VETERUJE	YMER	HOXHALLARI	
	ELVIRA	SHYQYRI	QOSEJHOXHA	
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA				
696	KOMUNITETI	MYSLIMAN	MYFTINIA	300.7
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA				
697	JANI	SAMI	CAPO	52
698	KLEAT	JANI	CAPO	
699	ERMIR	JANI	CAPO	
QARKU KORÇË, ZVRPP KORÇË, ZONA KADASTRA				
700	741359	344 23	8537	2 938 694 51
DREJTORIA E ALUIZNI-t LUSHNJE				
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 8571, ZVRPP				
701	FLAMU	SHEFIT	PEQINI	297
702	SULEJMA	BEQIR	SULEJMANI	209
703	ALTIN	GANI	TOROMANI	240
704	LUAN	GANI	TOROMANI	270
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 2999, ZVRPP				
705	FADIL	HASAN	HOXHA	74.8
DREJTORIA E ALUIZNI-t KAMEZ-VORE				
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
706	LUFTIM	QAZIM	CANI	342
707	SELMA	HASAN	DRENI	261.6
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
708	ERBLIN	MUSTAFA	KURTI	399
709	XHAVIT	SALI	ÇORJA	
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
710	SAMI	ISAK	HYSENAJ	354.9
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
711	LUAN	HASAN	HAMLLI	265.2
DREJTORIA E ALUIZNI-t VLORE				
QARKU Vlorë, ZONA KADASTRALE 8602, ZVRPP				
	KASTRID	MUÇO	BRAHIMMUÇO	
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 8531 ZVRPP FIER				
712	ARBEN	KUJTIM	BOGDANAJ	162.8
DREJTORIA E ALUIZNI-t LUSHNJE				
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 1620 ZVRPP				
713	Ramada	Veledin	Kananaj	109.86
	Antigoni	Llazë	Kananaj	
714	Ramada	Veledin	Kananaj	1605.32
	Antigoni	Llazë	Kananaj	
715	Ramada	Veledin	Kananaj	1082
	Antigoni	Llazë	Kananaj	
DREJTORIA E ALUIZNI-t KAMEZ VORE				
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1649 ZVRPP				
716	MURAT	GANI	HODA	172.8

QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3992 ZVRPP				
717	HYSEN,	ZEQIR	NDREU	305.2
	VASIP	ZEQIR	NDREU	
718	LAM	SAHIT	PEPKOLAJ	354.9
719	RAMADA	HYSEN	TOPUZI	220.7
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1066 ZVRPP				
720	BAJRA	RRUSTEM	SULAJ	445.5
721	ISA	HALIL	MICI	103.5
722	HAKI	SALI	ISUFI	298.5
723	HAJRULL	BEKTESH	DURO	318.9
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2066 ZVRPP				
724	LIMAN	REXHEP	DISHA	200.1
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
725	SOKOL	BAJRAM	DAFKU	214.6
726	BESNIK	AHMET	KURMETA	340.4
727	BESIM	LIMAN	PASHA	500
728	BLEDAR	BASHKIM	JEMINAJ	262.2
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
729	HAMIT	KURT	UKA	280
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
730	MYNYR	SADIK	DURAKU	385.5
731	NIKOLL	MIRASH	DAKAJ	277.5
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
732	ÇLIRIM	BESIM	MEMA	167.5
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
733	QEMAL	LIMAN	ALUSHI	678.3
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
734	XHEVAHI	HAMZA	KALOTI	248.05
735	XHEVAHI	HAMZA	KALOTI	120.7
736	SHEFOET	MEHMET	ZHUBI	299.85
737	BINAK	SELIM	BYBERI	333.4
738	CEN,HAS	HALIL	MICI	191.4
739	VALBON	XHEVAHIR	HIDRI	202
	KRISTIAN	SALI	HIDRI	
740	PRANVER	AJVVAZ	SULA	133.8
741	HAMDI	MIC	ISMAJLAJ	253.8
742	SELAMI	AVDYL	HAXHIAJ	192.7
743	AGIM	RAM	HYSENUKAJ	240
744	PREKE	NDUE	RRUSHI	238.65
745	SADIK	BAJRAM	KORTOCI	316.5
746	BILBIL	IBRAHIM	HASANAJ	186.6
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
747	LIMAN	MUHARREM	AXHA	256.5
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
748	BUKURUE	AHMET	KOVACAJ	259.5
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
749	FATMIR	KAPLLAN	BIZARI	438.9
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
750	RAMAZ	BEQIR	PASMACIU	233.6
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
751	PETRIT	DALI	ELEZAJ	267
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
752	DIN	ZENEL	LUSHI	327.6
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
753	PETRIT	SABRI	MOLLAJMERI	274
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
754	LUMTUR	MUHARREM,	SALKU	293.7
	DRITAN	SALIH	SALKU	
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
755	SOKOL	HALIT	LATA	423.9
756	SKENDE	HALIT	LATA	405.4
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
757	ARBEN	QAZIM	MUJA	44.9
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
758	ARTAN	BIB	MJEKAJ	226.5
759	NEVRU	IBRAHIM	MANDRI	227.55
760	SHAQIR	ABDI	SUÇI	183.6
761	SHERIF,	XHEMAL,	ZELA	327
	BESNIK	SHERIF	ZELA	
762	DALIP	ABDI	SUÇI	159.7
763	LULZIM	RAMIS	REÇI	245
764	BLEDJA	NAZIF,	BARA	408.6
	NAZIF	XHETAN	BARA	
765	BUJAR	AHMET	ALIU	339

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
766	HANE	ZYBER	KUÇI	294.9
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
767	SHKELQI	SHABAN	AGAJ	282.3
768	SKENDE	HALIT	SHEHI	469.7
769	XHAVIT	TAHIR	NDREU	388.8
770	FLAMUR	AVDI	MICI	348.6
771	JASHAR	MEHMET	BAJA	278.7
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
772	IBRAHIM	IZET	SULALLARAJ	357
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
773	FATMIR	QAZIM	KAZIU	301.5
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
774	MISLIM	AZIZ	DISHA	320.25
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
775	MALIK	BANUSH	PALUSHI	422.4
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
776	FIDAJET	FEHMI	KURTI	363.9
777	XHEVAHI	HAJREDIN	ALLARAJ	249.4
778	SHERIF	HYSEN	PALINCI	331.2
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
779	TEFIK	FERIZ	MENA	387.9
	IDRIZ	TEFIK	MENA	
	ASTRIT	TEFIK	MENA	
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
780	SOKOL	ZEF	DOCAJ	271.95
781	ASTRIT	SADIK	BALLIU	108
782	SERVETE	SELIM	STAFHASANI	214
783	LUSH	ZEF	PJETRA	342.8
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
784	PETRIT	SALI	GJOÇI	311.85
785	HANIFE;	SULE;	QENANAJ	430.5
	MONDJAN	KUJTIM	QENANAJ	
786	GARIP	ZENEL	QINAMI	356.7
787	HEKURAN	SELMAN	CANI	179.4
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
788	QEMAL	SELIM	HOXHA	204.3
789	BEXHET	AVDYL	ISMAILAJ	373.2
	ILIRJAN	AVDYL	ISMAILAJ	
790	BAFTI	PREL	MESHAJ	346
791	ALEKSAN	YMER	MAÇI	78.6
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
792	IBRAHIM	ABDYL	SHATRI	307.8
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
793	DRITAN	BESIM	MEMA	266.2
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
794	BAJRAM	RAKIP	VEJSELI	325.8
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
795	IZMIR	HAZIR	MUSTAFAJ	299.1
796	NIKO	MEHMET	GECI	113.1
797	SHPETIM	BRAHIM	ZELAJ	284.1
798	AVNI	MIFTAR	MEHMETAJ	33.6
799	ENDRI	BEQIR	XHAHU	294.5
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
800	SHEFOET	ALI	GJABRI	335.4
801	SHERIF	SELAM	NOKA	311.55
802	QEFSERE	ISMAIL	SHEHI	309.6
803	RRUZHDI	SALI	CANI	184.1
804	MEXHIT	ISMAIL	ZHUZHI	288.9
805	NDRIÇIM	ZENEL	PEPOSHI	255.9
806	FEMI	REXHEP	HOXHA	100.2
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
807	ALDO	AHMET	SHESHAI	305.4
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
808	FIQIRI	ZEQIR	RAKIPLLARI	216.9
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
809	AGRON	PETRIT	HOXHA	412.5
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
810	XHEZMIR	HAKI	VISHA	312
811	FERIT	ISUF	HASI	324.3
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA				
812	ERVIS	AHMET	REKA	459

## JONIDA VOKSHI TREGON SIE PRITËN FAMILJARËTE SAJ LAJMIN SE DO MARTOHEJ



Ajo është përfolur shpesh nëpër media rozë për jetën e saj private dhe një lidhje të mundshme me dj Sardin, por mesa duket nuk qenka aspak e vërtetë. Në fakt, moderatorja është e lidhur prej kohësh me producentin Besnik Krapin dhe shpejti biles do të lidhin kurorë. Pas këtij lajmi të mirë, Jonida Vokshi tregoi po ashtu se si e priten këtë lajm familjarët e saj. Gjatë emisionit "Xing me Ermalin" në Tv Klan ku ajo ishte e ftuar, u shpreh se ata u gëzuan shumë dhe se ajo ishte e këndshme në hije dhe duan më shumë Besnik Krapin. Ajo tha se martesja e tyre është konkludim i dashurisë që kanë për njëri-tjetrin dhe se vendimi i tyre nuk ka të bëjë me faktin që shpesh prindërit iu kërkojnë fëmijëve të tyre të martohen dhe të krijojnë familje. Ermal Mamaqi: Tërë këto vite në heshtje... A u gëzuan ata të shtëpisë? Se halli familja është, njëzëjt ndonjëherë martohen për familjen. Mos ndoshta t'i po e ben këtë për familjen? Jonida Vokshi: Jo unë po e bëj për veten time, për dashurinë që kam për Besnikun, Besnik Krapin. Ermal Mamaqi: Po shqyrr që e the se plasëm. Jonida Vokshi: Pasi ia thamë familjarëve lajmin, sigurisht u gëzuan shumë, por tani familja ime do më shumë Besnikun se sa mua. Kam kaluar në hije. Besniku ka mbaruar për aktor dhe është producent.



**R**eperi Majk festoi një ditë shumë të veçantë dje. Kjo sepse djali i tij i vogël, Roan, festoi dyvjetorin e lindjes dhe me këtë rast, reperi nuk ka hezituar t'i dedikojë disa fjalë të sinqerta prindi. Ai ka publikuar në rrjetin social 'Instagram' një sërë fotografish me të birin, të cilat kanë marrë pëlqime dhe komente të shumta nga ndjekësit. "Çdo send që do ta arrijë në jetë, kam për ta bërë veç me të pa ty të lumtur, ti je mishi im, ti je gjaku im, ti je krijesa më e bukur... urime ditëlindja e dytë, zemra e babis. Zoti të bekoftë", ka shkruar reperi në 'Instagram'. Ndërkohë, të shumta kanë qenë urimet edhe nga ana e fansave që Majk ka pranuar për të birin. Ndërkohë dedikime speciale për ditëlindjen e të voglit ka pasur edhe nga nëna e tij, Majlinda Zeka. "Dje dy vite ishte dita më e lumtur e jetës sime, Zoti më bekoji me ty Roan. Urime ditëlindjen jeta e mamit, paç fatin dhe lumturinë e botës", ka shkruar Zeka në 'Instagram'.

**Majk me urim  
emocionues për  
ditëlindjen e të birit**

## Fjoralba Ponari nis emisionin e ri, ja ku do ta shohim ditën e hënë



**F**joralba Ponari është kthyer shpejtë në një nga moderatorët më të pëlqyer të publikut. Jemi mësuar ta shohim çdo të diel, në 'E diell' në 'Top Channel'. Së fundmi, është zbuluar se Fjoralba do të nisë një emision të ri në ekranin e 'Top News' ditën e hënë. Sipas 'Top Channel', emisioni i ri do të zgjasë 15 minuta dhe moderatorja do të flasë mbi të rejat e jetës urbane, si dhe histori të ndryshme suksesi nga të rinj dhe të reja me nisma të veçanta. Pas suksesit të saj në 'E diell', edhe emisioni i ri i Fjoralbës me siguri do të rezultojë i tillë.



**I**sh-mesfushori i Kombëtares shqiptare ka përfjetuar dje për herë të dytë emocionin e bukur të të berit baba. Erion Bogdani ka ndarë me ndjekësit e tij në 'Instagram' lajmin e bukur se dje familjes së tij ju shtua një vajzë të cilën prindërit e kanë quajtur Alice. "Asgjë nuk është më e bukur sesa një jetë e re që lind" ka shkruar ish-futbollisti në postimin e tij. Erion Bogdani dhe bashkëshortja modelja Rosella janë edhe prindër të një djali 8-vjeçar.



**Erion Bogdani  
bëhet baba për  
herë të dytë**





## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:  
Si të trajtoni  
dhimbjet e kyçeve  
brenda një jave

## KESHILLA



ISHP: Mënyra  
të thjeshta për t'u  
mbrojtur nga  
temperaturat e larta

# Lorela Garuli:



◆ Psikologia:  
S'kanë interes  
për procesin  
mësimor, shkak  
inteligjenca e  
lartë

# Fëmijët me dhunti më të larta se mesatarja

"Si mund t'i identifikoni,  
karakteristikat kryesore"

• Çfarë shkakton mospirja e ujit, rastet e overdozës. Kujdes me konsumin e tepërt të kripës, shkakton probleme me zemrën

Psikologia: S'kanë interes për procesin mësimor, shkak inteligjenca e lartë

# Lorela Garuli:

## Fëmijët me dhunti më të larta se mesatarja

"Si mund t'i identifikoni, karakteristikat kryesore"

Voltiza Duro

Shoqëritë me një të kaluar totalitare kanë tendencat e pranishme mes individëve të shoqërisë dhe prirjen drejt mesatarizimit social, klasor dhe intelektual. Sot për sot, në Shqipëri ndihmohen dhe nxiten të integrohen individë me vështirësi, çrregullime dhe problematika të ndryshme të zhvillimit, ndërkohë që ka shumë pak vëmendje për fëmijët dhe të rinjtë që kanë dhunti apo talente të caktuara. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", psikologja Lorela Garuli tregon mënyrat se si mund të identifikohen fëmijët me dhunti të veçanta dhe karakteristikat kryesore që ata shfaqin. Më tej psikologja jep sugjerime të vlefshme për mënyrat e sjelljes që prindërit duhet të tregojnë me fëmijë të tillë.

**Pse duhet treguar kujdes i posaçëm ndaj fëmijëve me dhunti të veçanta?**

Është e domosdoshme që pjesë e programeve dhe planeve edukative e didaktike që synojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta të jenë dhe veçoritë dhe nevojat e fëmijëve me dhunti apo me aftësi më të larta se mesatarja. Kjo me qëllim jo vetëm për t'ju përgjigjur nevojave të tyre intelektuale dhe njohëse, por njëkohësisht për të ndikuar pozitivisht në edukimin e tyre në të ardhmen; sepse janë pikër-

ishtë këta individë, që trajtuar, shkolluar dhe edukuar në mënyrën e duhur do të kontribuojnë në shoqëri. Pra, njohja e tipareve të tyre dhe kultivimi i aftësive dhe talenteve është në të mirë të të gjithë shoqërisë ku ata jetojnë.

**Si identifikohen këta fëmijë?**

Parimisht, është shkolla, e cila i pikas dhe e kupton kur një fëmijë zotëron inteligjencë më të lartë sesa të tjerët, mëson më lehtë dhe më shpejt, apo kur shfaq prirje në fusha të caktuara. Por, ajo që ndodh realisht është se një pjesë e madhe e këtyre fëmijëve nuk arrihen kurrë të zbulohen, si rrjedhojë e mungesës së informacionit mbi këtë çështje dhe kryesisht nga mungesa e instrumenteve matës të inteligjencës në gjuhën shqipe.

**Cilat janë veçoritë që shfaqin**

**kryesisht?**

Në pjesën më të madhe të rasteve, fëmijët që kanë një inteligjencë më të lartë apo një talent tjetër që nuk lidhet detyrisht me shkollën, shfaqin kujtesë shumë të mirë për moshën kronologjike, kuptojnë ide abstrakte dhe të komplikuar, janë të aftë të zgjidhin problema dhe detyra më të avancuara sesa për moshën, janë shumë kureshtarë, kanë fantazi, imagjinatë dhe një të menduar abstrakt shumë të zhvilluar. Janë fëmijë me fleksibilitet të lartë në të menduar, me iniciativë, originalë dhe produktivë. Janë fëmijë që mësojnë shumë shpejt, e artikulojnë gjuhën shumë mirë, të cilët përdorin fjalë dhe fjali më komplekse sesa bashkëmohatarët e tyre dhe që në



Psikologja Lorela Garuli

moshë të hershme kanë të zhvilluar një fjalor shumë të pasur.

Zakonisht u pëlqen më shumë të lexojnë sesa të luajnë jashtë dhe arrijnë të jenë autodidaktë shumë të mirë. Të mësuarit e gjërave të reja e perceptojnë si një proces dinamik, të kënaqshëm dhe të këndshëm.

**Si shfaqen ata në marrëdhënie me të tjerët?**

Nuk janë të rralla rastet që janë të paimterësuar dhe jo të motivuar për procesin mësimor apo për aktivitetet tipikë që kryejnë bashkëmohatarët e tyre. Kjo ndodh për arsye të thjeshtë, sepse mungesa e interesit lidhet direkt

me inteligjencën më të lartë dhe me faktin që si programet mësimore, ashtu dhe ato argëtuese me moshë të caktuara, janë të hartuara duke pasur parasysh një nivel mesatar të zhvillimit konjitiv; programe të cilat nuk përmushin "etjen" dhe interesat e veçantë e të zhvilluar të këtyre fëmijëve.

**Mund të na përshkruani disa prej karakteristikave të personalitetit të fëmijëve me dhunti të veçanta?**

Sa i përket karakteristikave të personalitetit, shfaqjen të pavarur, të përgjegjshëm, kritikë dhe shpeshherë me prirje perfekcioniste. Janë të ndërgjegjshëm për pikat e tyre të forta dhe të bindur tek vetja. U pëlqen më shumë të komunikojnë me fëmijë më të rritur sesa ata vetë.

**Si duhet të sillen të rriturit me ta? Çfarë sugjeroni për prindërit e këtyre fëmijëve?**

Identifikimi i hershëm i këtyre fëmijëve dhe i tipareve të tyre ndihmon në radhë të parë që vështirësitë që ata mund të shfaqin në përshtatje me të tjerët apo me mjedisin, të kuptohen drejt. Nëse shfaqin mungesë vëmendje dhe angazhimi, duhet kuptuar drejt nga ana e të rriturve se kjo vjen nga mënyra e tyre e ndryshme e perceptimit dhe e njohjes së realitetit. Ajo që sugjerohet për prindërit e këtyre fëmijëve është që të kultivojnë dhe të ushqejnë interesat dhe talentet e fëmijëve, gjithmonë sipas dëshirës së tyre. Njëkohësisht duhen nxitur marrëdhëniet e shëndetshme sociale dhe të plotësohen të gjitha nevojat e tjera të fëmijës, jo vetëm ato mendore dhe intelektuale.





Voltiza Duro

**A**rtriti reumatoid është një sëmundje inflamatore kronike sistematike me periudha acarimi dhe qetësimi ku prekja kryesore është dëmtimi i kyçeve, por nuk përjashtohen edhe preket ekstra-artikulare (zemër, lëkurë, mushkëri, sy). Të gjitha sëmundjet si artriti reumatoid, borsiti, menisqet, problemet e dhimbjeve lumbare, hernia diskale, pak a shumë kanë të njëjtën natyrë. Në thelb ato janë veçse një infeksion alergjik që prek membranat sinoviale. Këto membrana janë si qese që mbajnë lëngun sinovial, dhe ky i fundit ndodhet midis kockave dhe kyçeve e nuk i lejon ato që të fërkohen e të konsumojnë njëra-tjetrën. Ky inflamacion alergjik që ndodh në kyçe prek moshë nga më të ndryshmet, duke filluar që nga moshat 20-30 vjeçe. Fillimisht këto baktere qëndrojnë në gjendje pasive, por bëhen aktive në momentin që depozitohen në palcën e kyçeve të kockave dhe nëpër kyçe e shkaktojnë dhimbje. Format më të njohura janë disa, ku mund të përmend Shafarad Stilid, i cili shfaqet në moshat 3-7 vjeçare, si pasojë e një sëmundjeje të shpeshtë në bajame apo veshka. Këto dhimbje bëhen aq të bezdisshme, sa fëmijët mund të arrijnë në atë pikë sa nuk lëvizin dot. Një tjetër formë është artriti kronik, që përparon në mënyrë progresive në trupin e njeriut dhe dhimbja vjen duke u përshkallëzuar. Ndërsa, poliartriti është një lloj tjetër i artritit, që fillon të lëvizë në pjesë të ndryshme të trupit, pra quhet ndryshe edhe artriti "shëtitës", ku dhimbja në momente të ndryshme, lokalizohet në pjesë të ndryshme. Ka dhe forma të tjera, si gonoartroza, e cila ndodh kur në pjesën e kuppave të gjunjëve lëngu sinovial fillon të thahet, dhe këtu depozitohen stafilokokë. Në rastet kur pacienti ka mungesë të theksuar lëngjesh, kjo shpeshherë, shoqërohet edhe me kërcitje të kockave. Një formë tjetër është dhe artriti urik, i cili lidhet drejtpërdrejt me sasinë e lartë të acidit urik në organizëm.

### Shkaktarët

Në rastet kur tregoheni të pakujdesshëm në kurimin e bajameve, gjëndrat limfatike fillojnë të acarohen dhe prodhojnë limfocitet T, të cilat shumohen në numër dhe trupi prodhon antikorpus kundër faktorit reumatoid që është shumë. Këta stafilokokë që zhvendosen nga ba-



Mjeku popullor: Sëmundja prek të gjitha grupmoshat, shkaktarët kryesorë

## YLLI MERJA: Si të trajtoni dhimbjet e kyçeve brenda një jave

### "Efektet e mrekullueshme të vajit të sinapit"



Mjeku popullor  
Ylli Merja

jamet, shkojnë në veshka, e më tej hyjnë në qarkullimin e gjakut. Nëse një trup nuk funksionon në mënyrë të sinkronizuar, duke përfshirë këtu gjëndrat endokrine dhe organet e tjera, është më i predispozuar për t'u prekur nga këta ngacmues të jashtëm, ku përfshihen edhe këto baktere që shkaktojnë sëmundjen e artritit. Me kalimin e kohës fillojnë shqetësimet e para, që shoqërohen me ndjesi këputjeje, lodhjeje, temperaturë, dhimbje gjun-

jesh e kockash si dhe me mungesë oreksi. Këto shenja shfaqen kur stafilokokët hyjnë në gjak e fillojnë të bëhen aktivë, të shumohen dhe të përhapen në trup. Stadi i dytë i kësaj sëmundjeje progresive është që, nëse nuk kurohet, ai përparon në mënyrë të përshkallëzuar. Gjatë këtij momenti kemi përhapje simetrike në të dyja gjymtyrët, dhe fillon të japë dhimbje, dobëson enët e qarkullimit të gjakut dhe i hollon. Këto të fundit, me ndryshimin e shtypjes atmosferike bëhen të

brishta dhe ulja e shtypjes shkakton deformimin e kockave, që shfaqet më tepër në gishtat e këmbës dhe të dorës.

### Trajtimi

Duke njohur shumë mirë vetitë kuruese të disa bimëve, ne filluam t'i testonim ato që para 10 vitesh dhe morëm rezultate tepër pozitive. Ne e dimë që artriti dëmton edhe zemrën, kështu që në kompozimet e çajit kurues shtuam edhe bimë që mbrojnë zemrën. Nuk përdorim vetëm një bimë, por duke ditur vetitë e përafërta të bimëve mjekësore, kemi kompozuar këtë çaj, që redukton acidin urik të ngritur, i cili jep edhe probleme në veshka, si dhe të sjellë një funksionim të mirë të qarkullimit të gjakut në arterie dhe vena. Aty ku gjaku qarkullon lirshëm, shkojnë edhe lëndët ushqyese dhe oksigjeni. Pacientët duhet të pinë një gotë çaj që ne e përgatisim me bimë mjekësore në çdo vakt. Ne në kompozimin e këtij çaji futëm bimë që të mbrojnë edhe zemrën. Lëvorja e shelgut është një tjetër trajtim që përdorim për pacientët, pasi hollon gjakun. Edhe vaji i sinapit është një preparat shumë i mirë, që nxit qarkullimin e gjakut dhe ndihmon në kurimin e artritit.

Zgjidhja e problemit të artritit reumatoid është e dukshme brenda një periudhe kohe shumë të shkurtër, pra brenda një jave.

### Diagnostikimi

Një pacient, i cili verifikon se ka disa nga simptomat e sipërpërmendura, mund të kryejë disa diagnostikime, si faktori reumatoid, fibrinogjenin, proteinën C reaktive dhe acidin urik. Në momentin që acidi urik rezulton i lartë, atëherë pacienti ka depozitime të larta të kalciumit në kocka,

**A**rdhja e stinës së verës pritet të shoqërohet me rritje temperaturash si dhe me dëshirën tonë të madhe për t'u ekspozuar sa më shumë në diell. Ne mund të ndihemi mirë në diell, sidomos kur kemi dalë nga stina e dimrit. Por, kujdes! Qëndrimi i gjatë në diell mund të sjellë pasoja dhe probleme të shumta për shëndetin. Instituti I Shëndetit Publik liston më poshtë disa këshilla të vlefshme për kujdesin që duhet të tregojmë gjatë kësaj stine. Kur temperatura e ambientit është më e lartë se temperatura e lëkurës, djersitja është i vetmi mekanizëm efikas ftohës në dispozicion të trupit të njeriut. Në kushtet e temperaturave të larta, shumë të larta apo ekstreme të mjedisit ky mekanizëm nuk është i mjaftueshëm... Gjithashtu, ka edhe disa faktorë të tjerë që e reduktojnë mundësinë për djersitje dhe shkaktojnë mbinxheje të trupit. Faktorë të tillë janë; moshë, mungesa e lëngjeve (dehidratimi), përdorimi i veshjeve jo të duhura, disa lloje sëmundjesh kronike si dhe përdorimi i disa medikamenteve mjekësore. Në Shqipëri rrezatimi diellor është më i fortë midis muajve maj dhe gusht, prandaj këshillohet që gjatë kryerjes së aktiviteteve tuaja të përditshme të mos abuzohet me ekspozimin në diell dhe të tregojmë kujdes ndaj temperaturave të larta.

Në hije rrezet ultraviolette reduktohen deri 50% e tyre. Përdorimi i veshjeve prej pambuku lejon kalimin në trupin tonë vetëm 10% të rrezeve ultraviolette, në një kohë që në ujë kalojnë rreth 95% e këtyre rrezeve. Efektet e temperaturave të larta në shëndet ndodhin kur sistemi i rregullimit të temperaturës së trupit tonë nuk arrin të shpërndajë nxehtësinë e tepërt. Ndikimi i temperaturave të larta në shëndetin tonë varet nga koha e ekspozimit ndaj këtyre temperaturave, shpeshtësia e ekspozimit dhe intensiteti i ekspozimit. Goditja nga dielli vjen si rezultat i qëndrimit të gjatë në diell dhe shkakton rritje të temperaturës së trupit, zgjerim të enëve të gjakut, rënie të rrahjeve të zemrës dhe si pasojë shoqërohet me: djersitje të madhe, të përziera, dhimbje koke, marrje mendsh, ulje të presionit të gjakut, turbullim të shikimit, etj. Shpesh goditja nga dielli kërkon ndihmë të specializuar.

**Cilat janë efektet e të nxehtit mbi shëndetin tonë?**

Pasojat më të shpeshta që vijnë si rezultat i temperaturave të larta janë: Goditja nga dielli; Goditja nga nxehtësia; Dëmtimet në sy apo lëkurë; Infeksionet dhe intoksikacionet për shkak të ushqimeve të cilat manifestohen me diarre. Gjithashtu i nxehti mund të sjellë rëndimin e disa sëmundjeve të zemrës dhe tensionit. Të gjithë janë të rrezikuar nga efektet e tem-



# ISHP: Mënyra të thjeshta për t'u mbrojtur nga temperaturat e larta



peraturave të larta por ka disa grupe individësh që janë më të rrezikuar ndaj temperaturave të larta për arsye se aftësia për të rregulluar temperaturën është më e kufizuar, pra djersitja është më e pakët.

**Personat më të rrezikuar nga temperaturat e larta**

1. Foshnjat dhe fëmijët: janë të ndjeshëm ndaj efekteve të temperaturave të larta për shkak se metabolizmi i tyre ndryshon nga metabolizmi i të rriturve, qendra e rregullimit të temperaturës është e papjekur; aftësia për djersitje është më e pakët, masa e trupit është e vogël.

2. Të moshuarit: përbëjnë grupin më të madh të përcaktuar si grup në rrezik për shkak të nxehtësisë. Te të moshuarit ulet toleranca ndaj nxehtësisë, etja ndjehet vonë, reagimi i djersitjes

është i vonuar dhe numri i gjendrave të djersës është i reduktuar.

3. Individë me sëmundje kronike: Pothuajse të gjithë personat me sëmundjet kronike paraqesin një rrezik për përkeqësim të sëmundjes kronike apo për vdekje për shkak të nxehtësisë. Sëmundjet që paraqesin më shumë rrezik janë hipertensioni, sëmundje të zemrës; astma bronkiale, bronkiti kronik, pneumopatia obstruktive kronike; diabeti, insuficiencia e veshkave, rregullimet psikiatrike si skizofrenia, depresioni, demenca, gjendjet febrile, etj.

4. Personat që janë përdorues të rregullt të medikamenteve të ndryshme mjekësore: Shumë ilaçe mund të ndikojnë drejtpërdrejt në me-

kanizmat qendrore e periferike të termorregullimit, duke ndikuar në djersitje, në zgjerimin e enëve të gjakut të lëkurës, në rritjen e punës së zemrës dhe eliminimin e nxehtësisë.

5. Personat që punojnë në vende me temperatura të larta ose në ambiente të hapura (jashtë): Kushdo që punon jashtë në një mot të nxehtë, pa mbrojtjen e duhur, sidomos nëse ka edhe aktivitet fizik të rëndë, është në rrezik për shkak të efekteve të të nxehtit në shëndet.

6. Personat që bëjnë aktivitet fizik të rëndë.

7. Njerëzit që jetojnë në apartamente në katet e sipërme.

8. Grupet e popullsisë me kushte sociale jo të mira, individë të pastrehë, etj.

**SI TË MBROHENI NGA TEMPERATURAT E LARTA APO TË NXEHTIT**

- Evitoni nëse është e mundur daljet nga shtëpia në orët e nxehta të ditës, 11.00 - 17.00
- Vishuni lehtë, me veshje pambuku, me rroba të gjëra, dhe ngjyra të hapura, si në shtëpi edhe kur dilni nga shtëpia
- Mbani në kokë kapele, çadër dhe syze kur dilni jashtë
- Mbani shtëpinë sa më të freskët. Hapni dritaret herët në mëngjes dhe në mbrëmje vonë. Mbani mbyllur dritaret gjatë ditës
- Temperaturat në shtëpi duhen mbajtur deri në 25-27 ° dhe asnjëherë jo më shumë se 5-6° më pak se ambientit jashtë.
- Evitoni korrentet e mundshme
- Freskohuni herë pas here me ujë të freskët, duke bërë dush, ose duke u lagur me peceta për të ulur temperaturën e trupit, në krahë, qafë, ballë.
- Pini lëngje ose ujë në mënyrë të mjaftueshme të paktën deri 2 litra në ditë
- Mos përdorni pije alkoolike, lëngje me shumë sheqer apo kafeinë
- Konsumoni vakte të lehta me përbajtje të lartë uji, si zarzavate, fruta
- Gatvani dhe ruani ushqimet të sigurt
- Evitoni aktivitetet fizike të forta, sidomos në orët e nxehta të ditës, 11- 17
- Tregoni kujdes për fëmijët, të moshuarit, personat e sëmurë apo edhe të vetmuar.



# Këshilla

## Çfarë shkakton mospirja e ujit, rastet e overdozës

Uji është kudo që nga toka te majat e akullta malore e deri te qelizat e trupit të secilit prej nesh. Në varësi të pozicionit geografik, masës trupore, moshës dhe gjinisë, mesatarisht trupi i njeriut përbëhet prej 55-60% ujë. Bebet e sapolindura kanë edhe më shumë, trupi i tyre ka rreth 75 % ujë ndaj dhe mund të notojnë lehtësisht në ujë si peshqit. Por ky nivel i lartë uji në trupin e tyre bie menjëherë që në vitin e parë të jetës, duke arritur rreth 65%. Uji në trupin tonë lubrifikon nyjet e kockave, rregullon temperaturën e trupit dhe ushqen trurin dhe shtyllën kurrizore. Uji nuk gjendet vetëm në gjak, ai, gjithashtu, gjendet në tru dhe zemër: Uji përbën 3/4 e këtyre dy organeve. Kjo sasi është e njëjtë me sasinë e lëngjeve në një banane. Mushkëritë janë të ngjashme me një mollë, pasi përmbajnë 83% ujë. Madje edhe kockat e njeriut që duket të thata, përmbajnë 31% ujë. Çdo ditë trupi ynë humbet 2 deri 3 litra ujë nga djersitja apo lëvizjet, madje edhe tekta marrim frymë. Këto funksione janë thelbësore për mbijetesën tonë ndaj duhet të kompensojmë humbjen e lëngjeve. Ruajtja e balancës është e rëndësishme për t'u mos dehidratuar apo për të evituar overdozën e ujit në trup. Dehidratimi shkakton humbje energjie rënie të humorit, tharje të lëkurës dhe tension të lartë. Një truri të pahidratuar i duhet më shumë sforcë për të funksionuar. Overdoza e ujit, hyponatremia shkaktohet nga pirja e një sasive të madhe uji brenda një kohe shumë të shkurtër. Atletët janë shpesh viktimë të hiper-hidratimit. Specialistët deri më tani kanë thënë se duhet të konsumojmë 8 gota ujë në ditë. Por studimet e fundit tregojnë se kjo sasi varet nga pesha jonë trupore dhe mjedisi ku jetojmë. Sasia që duhet të konsumojmë është 2.5 - 3.7 litra në ditë për meshkujt dhe 2 - 2.7 për femrat. Rritja apo zvogëlimi i kësaj sasive varet nëse jemi të shëndetshëm, aktivë, të moshuar apo jetojmë në vende me temperatura të larta. Uji është lëngu më i shën-



detshëm për hidratim. Edhe disa pije të tjera si kafja apo çaji, mund të zëvendësojnë lëngjet. Ushqimi përmban një të pestën e sasisë së ujit që nevojitet gjatë ditës. Frutat dhe perimet si luleshtrydhja, kastravecet apo edhe brokoli përbëhen prej rreth 90% ujë, ndaj janë shumë të mira për hidratimin e trupit. Konsumi

i ujit ka edhe efekte pozitive afatgjata. Studimet kanë treguar se balanca e ujit në trup eviton rrezikun nga ataku kardiak, nga diabeti, madje redukton edhe riskun ndaj disa kancerëve. Të marrësh sasinë e duhur të lëngjeve ndikon së tepërmi në mënyrën sesi ti ndjen, mendon dhe funksionon në jetën e përditshme.



Kujdes me konsumin e tepërt të kripës, shkakton probleme me zemrën

Deri më tani, ekspertët kanë pranuar se kripa e tepërt rrit rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare dhe tensionit të lartë të gjakut. Një studim i publikuar në revistën Nature Neuroscience, arrin në konkluzionin se kripa e tepërt shkakton mangësi në funksionet e trurit tek njeriu. Shkencëtarët shpjegojnë se duke e tepruar me kripën, njeriu është më i prekur nga ishemia, sëmundjet e zemrës dhe probleme të ndryshme me funksionet e trurit. Të dhënat shkencore tregojnë se kripa arrin të dëmtojë funksionin e qelizave endoteliale brenda enëve cerebrale të gjakut. Problemet me



këto qeliza, përfshirë këtu edhe furnizimin e mangët të trurit me oksigjen, përbëjnë gjenezën e shumë sëmundjeve kronike. Studimi i përmendur më lart vëzhgoi rolin e kripës në shëndet për një periudhë 12 javore. Gjatë kësaj periudhe, eksperimentoi tregoi se një regjim ushqimor me shumë kripë prish funksionin e qelizave të trurit. Ky regjim gjithashtu pakëson furnizimin e trurit me oksigjen. Nga ana tjetër, shkencëtarët zbuluan se kripa rrit nivelin e rruazave të bardha të gjakut që gjenden në stomak dhe mbajnë emrin TH17. Numri i lartë i tyre rrit nivelin e një molecule L-17 që nxit inflamacionin. Prania e saj ka ndikime negative në shëndetin cerebrovaskular. Ky zbulim, nënvizon praninë e një lidhjeje të fortë mes stomakut dhe trurit. Kjo lidhje duhet marrë në konsideratë në përzgjedhjen e një regjimi ushqimor. Lajmi i mirë sipas ekspertëve, është se ndikimet negative të kripës mund të zmbrapsen. Kjo ndodh nëse njeriu bën ndryshimet përkatëse në regjimin ushqimor.

Kosova pengon Gjuriçin, serbët mbushin qendrat e votimit me 464 vëzhgues

# Zgjedhjet në katër komuna të Kosovës, ja sa shqiptarë e serbë votuan

*Vuçiç-qytetarëve: Dilni në zgjedhje, tregoni sa e doni Serbinë!*

Në katër komunat veriore të Kosovës, në Mitrovicën e Veriut, Leposaviç, Zvečan dhe Zubin Potok, dhe u mbajtën zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarët e këtyre komunave. Votimi është hapur në orën 7:00 të mëngjesit të së dielës dhe qendrat e votimit janë mbyllur në orën 20:30 të mbrëmjes. Në një konferencë për media, është njoftuar se procesi i zgjedhjeve për kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Leposaviç, Zvečan dhe Zubin Potok, ka shkruar në mënyrë të rregullt. Sipas DNV dalja e qytetarëve në votime deri në ora 16:00 ishte 35%. DNV ka bërë të ditur se krahasuar me zgjedhjet e vitit 2017, dalja e qytetarëve në zgjedhje ishte më e madhe. Lista Serbe, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, janë në garë për këto vota në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarët e katër komunave, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvečan e Leposaviç. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tha se janë hapur 44 qendra të votimit me gjithsej 87 vendvotime dhe procesi është tash për tash i rregullt dhe pa ndonjë vështirësi. Votimet po ndiqen nga 464 vëzhgues vendas e ndërkombëtarë, përfshirë edhe ata të Bashkimit Evropian dhe 12 ambasadat të huaja si dhe Organizatës për Siguri e Bashkëpunim në Europë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se të gjitha vendvotimet janë hapur me kohë dhe se votimi po zhvillohet në rregull. Kryetarja e KQZ-së, Valdeta Daka tha se zgjedhjet u mbajtën pa asnjë problem. "Deri në ora 11:00 të drejtën e votës e kanë shfrytëzuar 9.361 qytetarë më të drejtë vote nga 57.983 sa është numri i përgjithshëm i qytetarëve më të drejtë vote në këto katër komuna", tha Daka gjatë një konference për media. Në zgjedhjet për kryetar të këtyre komunave janë kandidatët nga Lista Serbe, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje. Bazuar në renditjen e KQZ-së, në garë për kryetar të Leposaviçit janë Fisnik Veseli nga Lëvizja Vetëvendosje, Shaqir Hetemi nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Zoran Todiq nga Lista Serbe. Në Zubin Potok garojnë Liridona Kahirmani nga Lëvizja Vetëvendosje, Hysen Mehmeti nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Sërnxhan Vullloviç nga Lista Serbe. Në Zvečan, për kryetarin e



## NATAYLA APOSTOLOVA

"BE-ja pret që të gjithë aktorët e përfshirë në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë në katër komunat në veri të Kosovës të respektojnë integritetin e procesit zgjedhor. BE-ja thekson rëndësinë e respektimit dhe zbatimit të rekomandimeve të Misionit Vëzhgues të BE-së nga zgjedhjet e kaluara", ka theksuar Apostolova.

## ALEKSANDAR VUÇIÇ

"Le të dalin nesër në zgjedhje, të votojnë sipas ndërgjegjes së tyre, në katër komunat veriore të Kosovës. Le të dalin e të tregojnë se sa e duan Serbinë dhe të tregojnë se do të luftojnë për të ardhmen e atyre. Kjo është lutja ime", ka thënë Vuçiç.

## HASHIM THAÇI

"Kosova ka ndërtuar traditë të zgjedhjeve të suksesshme. Zgjedhjet në katër komunat veriore të Kosovës po mbahen sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe janë në shërbim të integritimit sa më të mirë të të gjitha komuniteteve në institucionet e Kosovës. Kandidatëve të kryetarit u uroj suksese dhe i ftoj që të vazhdojnë të punojnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve në komunat e tyre", ka shkruar Thaçi.

kësaj komune garojnë, Avdi Peci nga Lëvizja Vetëvendosje, Ilir Peci nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Vuçina Janković nga Lista Serbe. Kurse, në Mitrovicën e Veriut garojnë, Erden Atić nga Lëvizja Vetëvendosje, Gonxhe Çausi nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Goran Rakiç nga Lista Serbe. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi i ka përgëzuar subjektet politike dhe qytetarët në komunat veriore për, siç ka thënë ai, fushatën e qetë zgjedhore dhe ka uruar që të ketë një proces të rregullt zgjedhor. "Kosova ka ndërtuar traditë të zgjedhjeve të suksesshme. Zgjedhjet në katër komunat veriore të Kosovës po mbahen sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe janë në shërbim të integritimit sa më të mirë të të gjitha komuniteteve në institucionet e Kosovës. Kandidatëve të kryetarit u uroj suksese dhe i ftoj që të vazhdojnë të punojnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve në komunat e tyre", ka shkruar

Thaçi në 'Facebook'. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se në ditën e votimit do të hapen 44 qendra të votimit me gjithsej 87 vendvotime. Janë 12 kandidatë në garë për kryetar në këto komuna, nga tre kandidat për secilin komunë. Në katër komunat ku do të mbahen zgjedhjet, të drejtë vote kanë 57 mijë e 938 votues. Në Leposaviç, të drejtë vote kanë 18.164 persona, në Zubin Potok 8.535, në Zvečan 9.229 votues dhe në Mitrovicën e Veriut 22.055 persona më të drejtë vote. Lista votuese është bazuara në ekstraktin e Regjistrimit Qendror Civil, i cili përpilohet nga Agjencia e Regjistrimit Civil. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka akredituar 464 vëzhgues të zgjedhjeve të cilët përfaqësojnë dy parti politike, dy misione ndërkombëtare, një nga Komisioni Evropian, dy misione diplomatike, 12 ambasada, një organizatë joqeveritare ndërkombëtare, katër organizata joqeveritare vendore dhe 15

media. Zgjedhjet në veri u vëzhguan dhe nga koalicioni i organizatave joqeveritare Demokratia në Veprim (DnV). "Sipas të dhënave të terrenit, të gjitha vendvotimet janë hapur me kohë. Në 68 për qind të qendrave të votimit është raportuar për prezencë të zyrtarëve policorë Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar për prani të materialit propagandues të subjekteve politike brenda diametrit prej 100 metra të Qendrës së Votimit, në vetëm një qendër votimi, në Leposaviç", thuhet në njoftimet e para të këtij koalicioni. Përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova ka kërkuar që zgjedhjet të jenë transparente, gjithëpërfshirëse dhe të besueshme. "BE-ja pret që të gjithë aktorët e përfshirë në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë në katër komunat në veri të Kosovës të respektojnë integritetin e procesit zgjedhor. BE-ja thekson rëndësinë e respektimit dhe zbatimit të rekomandimeve të Misionit Vëzhgues të BE-së nga zgjedhjet e kaluara", ka theksuar Apostolova. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i serbëve u mbledhën në sheshin "Car Lazar", në veri të Mitrovicës, aty ku u mbajtën zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune. Tubimi i tyre është bërë me qëllim që të votojnë në mënyrë të organizuar në qendrat e votimit, zgjedhje këto që kanë nisur me rregullsi në orët e para të kësaj të dielle. Drejtori i të ashtuquajturës Zyrë serbe për Kosovën, Marko Gjuriç, siç raportojnë mediat kosovare nuk është lejuar të hyjë në

territorin e Republikës së Kosovës edhe pse kishte paralajmëruar një vizitë të tillë. Nga ana tjetër, Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ka bërë të ditur shifrat zyrtare se sa ka qenë numri i qytetarëve që morën pjesë në zgjedhjet në katër komunat veriore. Sipas këtij institucioni të drejtë vote kanë 57.983 qytetarë. KQZ-ja njoftoi se do të mbajë pesë konferenca për media gjatë ditës së sotme për të dhënë detaje për procesin zgjedhor. Në orarin e përcjell nga KQZ-ja, konferenca e parë do të mbahet në orën 08:00 për të njoftuar për hapjen e qendrave të votimeve. Në ora 11:30, KQZ-ja do të njoftojë për numrin e votuesve deri në këtë kohë. Në Komunën e Leposaviçit garojnë tre kandidatë për kryetar, dy nga parti shqiptare dhe një nga një parti serbe, sikurse edhe në Zubin Potok, Zvečan e në Mitrovicën e Veriut, raportojnë mediat kosovare. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, më 8 prill kishte shpallur datën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për 19 maj në katër komunat veriore të Kosovës pas dorëheqjeve (27 nëntor, 2018) nga katër kryetarët e atëherëshëm të këtyre komunave si masë kundërshtuese ndaj taksës së vendosur nga Qeveria e Kosovës ndaj mallrave serbe. Ndërkaq këtë të diel, pak kohë para nisjes së votimeve, Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç i ka ftuar të gjithë serbët e Kosovës që të marrin pjesë masivisht në zgjedhje. Kjo thirrje sipas tij bëhet me qëllim që të gjithë qytetarët të tregojnë vullnetin se sa realisht

e duan dhe e admirojnë shtetin e Serbisë. "Le të dalin nesër në zgjedhje, të votojnë sipas ndërgjegjes së tyre, në katër komunat veriore të Kosovës. Le të dalin e të tregojnë se do të luftojnë për të ardhmen e atyre. Kjo është lutja ime", ka thënë Vuçiç për televizionin serb "Pink". Kujtojmë se kryetarët e komunave veriore: Zubin Potok, Zvečan, Mitrovicë e Veriut dhe Leposaviç, më 26 nëntor të vitit të kaluar dhanë dorëheqje, në shenjë pakënaqësie ndaj vendosjes së taksës doganore prej 100 për qind nga Qeveria e Kosovës për importet nga Serbia. Më vonë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, caktoi datën 19 maj për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat veriore.

## KANDIDATËT PËR KOMUNAT

Bazuar në renditjen e KQZ-së, në garë për kryetar të Leposaviçit janë Fisnik Veseli nga Lëvizja Vetëvendosje, Shaqir Hetemi nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Zoran Todiq nga Lista Serbe. Në Zubin Potok garojnë Liridona Kahirmani nga Lëvizja Vetëvendosje, Hysen Mehmeti nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Sërnxhan Vullloviç nga Lista Serbe. Në Zvečan, për kryetarin e kësaj komune garojnë, Avdi Peci nga Lëvizja Vetëvendosje, Ilir Peci nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Vuçina Janković nga Lista Serbe. Kurse, në Mitrovicën e Veriut garojnë, Erden Atić nga Lëvizja Vetëvendosje, Gonxhe Çausi nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Goran Rakiç nga Lista Serbe.



## Shqiptarja i habit të gjithë, shkruan roman kriminalistik

### "Shefi mafioz me zemër të ftohtë", 14 vjeçarja kërkon botues gjerman për librin e saj të parë

Në pamje të parë Gerta Miftari duket si çdo vajzë tjetër e moshës së saj. Por, kjo nxënëse megjithatë ndryshon nga shokët dhe shoqet e klasës. Kjo për faktin se Gerta ka shkruar një roman. Bëhet fjalë për romanin kriminalistik "Coldhearted Mafia Boss" (shefi mafioz me zemër të ftohtë). Romani ka mbi 90.000 fjalë, ndërsa në varësi nga disen-

ji mund të arrijë në 400 faqe dhe është shkruar në gjuhën angleze. Aktualisht, Gerta është në kërkim të një botuesi për të cilin ajo parapëlqen të jetë gjerman, i cili shpreson të mund t'ia ofrojë produktin e saj digital edhe në formë të shtypur. "Unë lexoj shumë", thotë 14-vjeçarja, prindërit e të cilës

vijnë nga Kosova. "Duke lexuar ndodh edhe të zemërohem kur gjërat që mua më pëlqejnë, nuk ndodhin në librat që i lexoj. Për këtë arsye unë shkruaj në mënyrën si më pëlqen mua. Ndërsa fantazia për një gjë ushqehet përmes leximit". Si media për rritimin e saj, Gerta Miftari ka zgjedhur platformën

online Wattpad. Këtë platformë e ka zbuluar përmes një teksti të publikuar në Instagram. Tregimi i saj që ka për subjekt martesat me detyrim, përbëhet nga 54 pjesë. Me pak fjalë, subjekti i romanit është ky: Clare Dixon, e lindur në Kosovë dhe e rritur në Amerikë, ka prindër të pasur. Këta duan



që, për të ruajtur perandorinë e tyre familjare, vazhën 20 vjeçe ta martojnë me detyrim me Daemon Thompson-in, pak më i vjetër se ajo. Ky është shef i një firme dhe njëri ndër njerëzit më të pasur në botë. Por Thompson është pjesëtar i mafies dhe detyrim me Daemon Thompson-in, pak më i vjetër se ajo. Ky është shef i një firme

## 150 mijë emigrantë u dyndën vitin 2018, bie ndjeshëm kërkesa për azil

# Si mund ta zgjidhë Europa, krizën e emigracionit?

## Kontinenti i vjetër si 'toka e premtuar', ja ç'vendosi KE

Le ta fillojmë me lajmin e mirë: Rreth 150.000 emigrantë tentuan të hyjnë në mënyrë të paligjshme në Evropë vitin e kaluar. Kjo shifër, përfaqëson një rënie prej 92 për qind që nga viti 2015. Numri i njerëzve që kërkojnë azil në kontinentin e vjetër, në vitin 2018 ishte 646.000, ose më pak se gjysma e asaj që ishte tre vjet më parë. Në terma numerikë, kriza e emigracionit në Europë duket ka mbaruar. Në rrafshin politik, kjo çështje mbetet më përçarëse si kurrë më parë. Përpara zgjedhjeve të këtij muaji në Parlamentin Europian, populistët pretendojnë se shoqëritë evropiane ndodhen të rrethuara, duke bllokuar përpjekjet për të dalë me një politikë të gjerë në kuadrin e BE-së për kontrollin e këtij problemi. Në një kohë kur tkurja e popullsisë kërcënon rritjen e Evropës, axhenda anti-emigrantëve e së djathtës ekstreme, është sa ekonomikisht katastrofike aq edhe cinike. Sabotimi i saj, kërkon që udhëheqësit evropianë të dëshmojnë se mund të shmangin ngërçet kaotike në trafikun e qenieve njerëzore, sikurse ai që e tronditi Evropën në vitin 2015 - dhe të përpiqet të rregullojë pranimin e të ardhurave në mënyrë të rregullt. Kjo do të thotë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të përbashkët për sigurimin e kufijve të Europës, reformimin e sistemit të saj të azilit, dhe hapjen e rrugëve të reja për emigracionin e ligjshëm. Në fushën e mbrojtjes së kufijve, BE-ja ka shënuar një përparim në rritje. Komisioni Europian, ka propozuar rritjen e buxhetit të Agjencisë Kufitare dhe Rojeve Bregdetare Evropiane në 11.3 miliardë euro për 6 vite duke filluar nga viti 2021, nga rreth 320 milionë euro këtë vit. Ndërsa kjo është një lëvizje premtuese, agjencia ka nevojë për më shumë kompetenca - dhe mbështetje nga shtetet anëtare - që të funksionojnë në mënyrë efektive. Komisioni dëshiron që stafi i agjencisë të rritet deri në 10.000 persona vitin e ardhshëm, por duhet ende të bindë qeveri-



të që të ofrojnë personel për këtë forcë sigurie, dhe të miratojnë standardet e përbashkëta të trajnimit. Zyratë kufitare dhe ata bregdetarë të BE-së, duhet të jenë gjithashtu të autorizuar të kryejnë detyra të caktuara krahas autoriteteve kombëtare, siç janë patrullimi i kalimeve kufitare, dhe kryerja e kontrolleve mbi identitetin e emigrantëve. Në mungesë të një force të përshtatshme patrullimi, BE është e pabërgatitur për krizën e ardhshme. Ndërkohë, rregullat e unionit duhet të racionalizohen, përmes një sistemi të përbashkët në mbarë BE-në për shpërndarjen e azilkërkuarëve në të gjitha shtetet anëtare, në vend se të kërkohet nga kërkuesit e tyre të përpunohen në vendet ku ata hyjnë fillimisht. Kjo do të bënte që shtetet në vijën e frontit, si Italia dhe Spanja, të mos bartin një barrë të shpërpjesëtar për strehimin dhe

përpunimin e azilkërkuarëve. Nëse qeveritë populiste si ato në Hungari dhe Poloni, refuzojnë të pranojnë pjesën që u takon, BE-ja duhet të ecë përpara edhe pa to. Presidenti francez, Emanuel Makron, ka lënë të kuptohet se do të anulohet anëtarësimi i Hungarisë dhe Polonisë në zonën Shengen, nëse këto vende refuzojnë të marrin azilkërkuarët që u takojnë. Ndërsa një hap i tillë ekstrem, nuk ka gjasa të merret në realitet, BE-ja nuk duhet të hezitohet të ndërmarrë masa ndëshkimore të tjera ndaj qeverive, që kundërshtojnë respektimin e rregullave të përbashkëta. Për shembull, Brukseli mund të kushtëzojë fondet e rregullimit strukturor, duke pasur si prioritet shtetet anëtare që respektojnë rregullat e përbashkëta të azilit. Përballë frikës nga emigrantët, zërat e moderuar duhet ta vënë theksin tek interesat afatgjata të

Evropës, për tërheqjen e punëtorëve nga pjesa tjetër e botës. Duhet të harmonizohet procesi për marrjen e vizës "Card Blue", një program për punëtorët me kualifikim të lartë, që u lejon atyre të punojnë në çdo shtet anëtar përveç Britanisë, Danimarkës dhe Irlandës. Brukseli duhet të ofrojë financim, për ndërtimin e partneriteteve ndërmjet qeverive individuale dhe vendeve jo-evropiane, që synojnë certifikimin e punëtorëve, të cilët mund të plotësojnë nevojat kritike të tregut të punës. Për tu "shitur" votuesve përfitimet nga pluralizmi, liberalët duhet të njohin kufijtë e saj. Bashkimi Evropian, ka nevojë të përshejtojë asimilimin e grupeve të emigrantëve në vendet pritëse, përmes rritjes së shpenzimeve për integrimin, dhe të programeve mësimi të gjuhës. Ai duhet të investojë shumë më tepër energji diplomatike në sigurimin e mar-

## Gjermani, politikani mysliman kërcënohet me vdekje

Politikani gjermano-turk Haluk Yildiz tha se ka marrë letra të shumta islamofobike dhe kërcënime me vdekje në javët e fundit, përpara zgjedhjeve të Parlamentit Europian (PE) më 26 maj, raporton Anadolu Agency (AA). Haluk Yildiz, kreu i subjektit politik pro-imigrimit, Aleancës për Inovacion dhe Drejtësi (BIG), tha se letrat janë dërguar nga persona të panjohur dhe përfshinin fytyrje dhe kërcënime ksenofobike. "Në një nga letrat ata thonin se e kemi kaluar vijën. Pohonin se vetëm gjermanët kanë të drejtë fjalë në këtë vend", tha ai, duke shtuar se këto kërcënime i marrin shumë seriozisht për shkak të dhunës së shtuar neonaziste në vitet e fundit. "Por, kërcënimet e tilla nuk do të na pengojnë. Ne do ta vazhdojmë luftën tonë politike këtu", tha ai. Yildiz është kandidati kryesor i BIG, parti e vogël e themeluar në vitin 2010 nga një grup emigrantësh në Gjermani. Partia shpreson të fitojë një vend në Parlamentin Europian për herë të parë.



rëshetjeve me vendet e Afrikës dhe Lindjes së Mesme, për të pranuar dhe mbrojtur azilkërkuarët, kërkesat e të cilave mohohen nga vendet e unionit. Retorika ksenofobike e populistëve të krahut të djathtë, është e rrezikshme dhe vetë-mposhtëse. Por, ajo ka rezonuar me anketat e ligjshme të opinionit

publik, rreth ritmit të ndryshimeve sociale. Mbrojtësit e projektit evropian, duhet të qëndrojnë pas një reagimi më të rregullt dhe më rigoroz ndaj dukurisë së emigracionit të paligjshëm, ndërsa krijojnë mënyra të reja sesi emigrantët të kontribuojnë në të ardhmen e Evropës. Marrë nga Bota.al

Opinion i Ditës

Nga Fatos Çoçoli

(vijen nga faqja 1)

...nga ne dinë për shkrimin e tij vetëm nga komentet e mediave dhe portaleve tona plot ngjyra. Kush kërkon në internet, mëson se Peter Tiede është gazetar i rregullt i gazetës së mirënjohur gjermane "Bild" (në gjermanisht "Fotografia"). Gazeta gjermane "Bild" është gazeta më e madhe në Evropë, me 2 milionë kopje në ditë dhe e gjashtëmbëdhjeta në botë për nga tirazhi. Vetë gazetari Peter Tiede përfaqëson një gladiator të njohur në rrethet gazetareske evropiane, të luftës për zbulimin e së vërtetës. Ka shumë sfida dhe beteja të tij, mes shkrimeve dhe intervistave që ka zhvilluar për debatin nuklear gjerman, apo më herët për ish-ministrin grek të financave Janis Varufakis, apo drejtuesin e opozitës në Turqi. Shpesh opinio-net e tij të guximshme bien ndesh me shumë interesa dhe realitete politikash në Gjermani dhe Evropë, por ky është Peter Tiede. Ka një fantazi të fortë dhe stil të shkruari sa të drejtpërdrejtë aq edhe figurativ. Mirëpo ta akuzosh atë për marrje pagesash nën dorë nga opozita jonë për të shkruar, është ose budallallëk me brirë, ose delir i mirëfilltë. Shqyrr që pas 110 milionë eurove të fituara nga Françesko Beketi(pronari italian i ish-televizionit privat "Agon") në dëm të shtetit tonë, edhe Tiede nuk mendoi të na hapte një gjyq për shpifje e të fitonte edhe ai ca miliona për dëmtim të imazhit si

# Furtuna "Bild" dhe e vërteta shqiptare



gazetar. Në përgjigjen e tij na përhëndeti si vend i mrekullueshëm me njerëz të mrekullueshëm, që nuk meritojmë as pozitën dhe as opozitën që kemi. Megjithatë, mes

gjetjeve të qëndrimit të tij katërditor në vendin tonë dhe opinioneve të përmbajtura në shkrimin e tij, gjykoj se ka shumë kundërthënie. Nuk mendoj se

vendi ynë e meriton ta quash" Shqipëria është shembulli kryesor i një vendi kaotik në duart e gangsterëve". Dhe kur lexova në gjermanisht titullin e shkrimit të tij : "Kryengritja në Shqipëri: përse digjet Ballkani?", nuk e di pse m'u kujtua reportazhi televiziv i gazetarit të televizionit italian shtetëror RAI 2, më 14 shtator 1998, kur raportonte nga Tirana se kryeqyteti ishte në mes të një lufte civile, mes shumë të shtënave, madje edhe tankeve nëpër rrugë. Ne të gjithë e dimë grushtin e dështuar të shtetit të asaj dite. E dimë se nuk kishte asnjë shenjë lufte civile. Sepse të realizosh një luftë civile duhen dy ushtri dhe dy kampe të kundërta të përbetuara. Sigurisht që këto gjëra që ne si qytetarë të këtij vendi i kishim të qarta, nuk kish-te mundësi se si t'i dinte gazetari i huaj që qëndroi vetëm 24 orë. Edhe pse i një vendi kaq fqinj me ne, si Italia. Megjithatë, shqetësimet e Tiede qëndrojnë. Janë të gjitha këtu në këtë vendin tonë, që Tiede e quan "të mrekullueshëm". Lidhjet e qeverisë me krimin e organizuar janë reale dhe furnizimi i hashashit është e konsiderueshëm. Megjithatë, për të gjithë delirantët e republikës së bananeve në mes të Evropës, bima kanabis mbillet tek ne, në Shqipëri në 1.2 kilometra

katrorë(nuk mund të mbillet në fushë se nuk mbin). Kërkon klimë malore. Dhe 1.2 kilometra katrorë të mbjellë përbëjnë 2 për qind të sipërfaqes sonë si shtet. Prodhohet 2 mijë tonë hashash në vit dhe ka vlerën(në Shqipëri) 200 milionë euro. Kjo është droga shqiptare autoktone, e prodhuar dhe e tregtuar në vend dhe jashtë. Nuk ka mundësi fizike të prodhohet më shumë. Kjo qeveri që kemi sot mbi kokë ka shumë kuresë të sajat. Ka bërë me mijëra gabime dhe me qindra fajë. Për të gjitha do të gjykohej në qershor 2021. Dhe vendimin do ta japë sovran. Deri atëherë, është qeveria jonë. Nuk është as e baronëve të drogës, as e kapove të kriminit. Ka lidhje me ta sa të duash, por as kryeministri dhe as ministrat e tij nuk janë anëtarë të kupolave kriminale. Kjo është e vërteta e thjeshtë që të gjithë ne që jetojmë në këtë vend, i madh e i vogël, e kemi mirë parasysh. Fantazitë, skenarët dhe teoritë e tejfryra mund t'i mbajmë dhe t'i fryjmë akoma në kafenet tona. Por të vërtetën lakurige e dinë mirë ata qindra mijëra prej nesh që, edhe pse të pakënaqur, madje shumë syresh të revoltuar me këtë qeveri të sotme, vendosën të mos i bashkoheshin thirrjeve dhe protestave të opozitës sonë jashtë sistemit.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID





Kritikë Artistike

# Engjëjt e Amerikës

Nga Josif Papagjoni

(vijon nga faqja 1)

... personazhet, në formën e engjëllit Emilia që i fanitej mes vegimeve të ndezuluara të Prajer Uollterit, fliste për shtetëtimin e botës në një udhë pa krye, në Kund-Askund, ku trajta parake e ngjizjes dhe e qenësisë humane të saj nga Zoti pa formë apo nga Anti-Zoti, mua sepse m'u kujtua narrativa brilante e Kadare në romanin e tij "Aksidenti", në të cilën shkrimtari ynë mendimprehtë sillte pikërisht atë rrokullimë të qenies njerëzore nëpër muzgjet e shtetëtim-it kozmik të mbushur me eposhin e kundërthënies, që diku-diku i iknin rregullit të çiftimit mashkull-femër dhe digjeshin yllësive të tjera të eposhit brenda të njëjtit seks. Sepse dashuria nuk ishte përjashtimisht lëndore dhe e sajuar veç për riprodhimin e saj, por një gravitet me krisjet dhe shkeljen e rregullit të "artë" të çiftimit, që konvencionet morale e kishin kthyer në lig e ndëshkim për të "pabindurit" apo të "demonizuar-it". E pikërisht ky engjëll-kumtar i vullnetit të Zotit, i luajtur me një pasion e fuqi imponuese nga aktorja Luli Bitri (disedi e paporitur për mua për zërin e saj të "butë" e të ngrohtë), ja ku ia beh në dy trajta: i bardhë në fillim dhe i zi në fund, siç gjithcka shfaqet e rishfaqet edhe të shpirti i njeriut dhe vetë Krijuesi i tij, Zoti: E Zeza dhe e Bardha, Drita dhe Errë-sira. Por nuk është thjesht një metaforë kjo, as thjesht shtrësa onirike e dramës për ta çuar personazhin në një kopsh plot ujëvara. Doemos jo si në Edenin e dikurshëm të fantazisë biblike prej nga njeriu ishte tëbarur për "mëkatën e parë", pra për seksualitetin e tij, i quajtur si një "turp" nga vetë i Madhi Zot, me organet e mbuluara fill nga gjetja e fikut. Përkundrazi, tashmë ai, njeriu i mëkatuar, ftohej të shkonte në një burim shërues diku në Jerusalem, ku lapërdharë e rinj të seksit do t'i shpëtonin lëngatave sfilitesë të sëmundjes së Sidës të dërguar si mallkim nga i plotpushtetshmi. S'është më kopja Adami-Eva si mashkull-femër (mëkati i PARË), por kopja mashkull-mashkull (mëkati i DYTË) i botës së sotme, kredhur në një kllapi moskuptimi dhe tëjetërsimi trajgik. Vallë a janë fajtor ata?! A duhen ndëshkuar? Kush mund t'i ndëshkojë? Ligji? Feja? Opinioni? Shkenca? A është krim dhe përdoheje morale homoseksualitetit?

Pikërisht këtu rri e vërteta e këtij teksti: të pranosh "tjetrin", të "ndryshmin", "të përjashtuarin", atë që nuk është njëjtësi yt. Dhe tjetra: Vallë a është mëkat të dashurosh njëjtësinë tënd, pra mashkull mashkullin? Fenomeni i homoseksualitetit, ndonëse në ligje e kodet fetare ndëshkohet si bjerrije, zvetënim dhe degjenerim qysh nga letrat e Shën Palit, jeta ndërkohë e ka pohuar se ai është diçka brenda njeriut, diçka gjenetike, jo si përjashtim, as si zvetënim, por e "ashtuqenë". Edhe shkenca gjithnjë e më shumë po i largohet idesë së çrregullimit psikik, ai fiziologjik apo turbullirave të orientimit seksual në moshën e femijërisë dhe pubertetit. Për shumëkë është e vështirë, në mos e pamundur, ta pra-



nosh homoseksualitetin, ca më tujtjetën në çift të dy meshkujve a dy femrave. Dhe trokitja e këtij problemi ka mbërritur edhe në dyert e shoqërisë shqiptare tejet maskiliste e patriarkale. Unë vetë, teksa ndija shfaqjen, e largoja mendjen nga "bezdia" që më jepte veprimi skenik, kur shpërfaqte elemente të domosdoshme konkretizimi lidhur me marrëdhënien homoseksuale, dhe rreksha drejt kuptimeve dhe, ca më shumë, aq sa mundja, drejt ndjeshmërive të personazheve, për të ndëratur katarsisin tim: pranimin e vuajtjes së tyre, të dashurive dhe dhembshurive reciproke, të solidaritetit dhe dhimbjeve. Dhe prandaj të ky shkrim dua t'i shmangem paksa ideve sfidante të tekstit, madje edhe regjisorës së guximshme të A. Kumbros (sa i përket përzgjedhjes dhe trajtimit të dramës). Dua të afrohem më pranë lojës së aktorëve, të cilët duhet të luanin diçka që nuk ishte "brenda" tyre, që nuk buronte prej subkoshnencës së tyre teksta ata realizojnë ngjashmëritë midis ndjeshmërive si njerëz me ndjeshmëritë e personazheve që mishërojnë, por kur, në këtë rast, identifikimi aktor-personazh realizohet në mënyrë të tërthortë përmes hamendësimit ("sikur" po dashuroj një femër e jo një mashkull).

Kam bindjen se Helidon F'ino në rolin e Roi Kon mbërriti në pjesën më të epërme të talentit të tij (së paku aq sa unë e kam parë atë). Ai ishte gjithë energji nga fillimi në fund, tërhohej me veten e të tjerët dhe drithëronte duke shpalosur një shpirt egërsan, mbushur përplot urretje ndaj shumëkujt (jo vetëm Rozembergëve të dënuar me vdekje si agentë sovjetikë). Edhe pse i gozdhuar në shtratit e të sëmurit, pa mundësi lëvizje e gjetikulimi, ai ngjante se lëvizte gjithë vrull nëpër scenë, ai e pushtonte vëmendjen tonës, na mbante lidhur pas vetes. Kjo u mundësua pikërisht falë një ndjeshmërie të fortë që ai përcillte, falë intesitetit të përjetimit të agonisë së personazhit dhe "zhvatjes" së çdo grime teje, falë urretjes që ai kishte ndaj kujtudo, i gatuar ashtu, në një mendjemadhësi dhe prepotencë shtypëse, të frikshme, sa dhe sfilitesë, falë paraqitjes së një shpirt-

ti mbushur krejt me millef, që vuante pamundësinë e hakmarrjeve të fundit, falë panikut që i shkaktonte vdekja e pritshme, çka e kishte trandur keqas mendjen hakmarrëse prej ekstremisti të Roi Konit. Por aktori befasisht, në fund, sikur bën një "mea culpa" të karakterit të tij: në grahmat e fundit të jetës ai thërret nënën, bëhet femijë, kërkon një prehrë ku të vërë kokën, një strehëz për t'u mbrojtur; një gjë të ngrohtë. Njerëzoria sikur kishte bujtur më në fund si paqe në shpirtin e egërsuar e të turbullt të tij dhe ti si spektator ndosh-tndoshta, e ke falur këtë njeri të mbrapshtë, sepse pendesat dhe sfidat e zullumeve dhe padrejtesive që kishte bërë i faniten në formën e halucionacioneve dhe kllapive të frikshme e torturorese (qëndrimi dhe qeshja e përhershme e zonjës Rosenberg pranë shtratit të tij të vdeqes etj).

Genti Deçka në rolin e Prajer Uollterit ishte figurja më mbresëlënëse për nga dallërisa shpirtërore, një shpirt tujtjase poetik, sa dhe i ngjitur me përytjime mitike, besëtytni, prej një Mesie tëjetëfarë, një Engjëlli flarabarëdhë që i kumtonte porosinë e shenjtja, apokalipsin e pritshtëm. Ndjeshmëria e tij fetare, e përzier me ëndërrimet poetike dhe erotike, të cilat barabiten me orgazmat, e bëjnë sa qesharak e naiv besimin e tij, aq dhe një nevojë për shpëtim, pranim, purifikim dhe transhencë. Nga të gjithë personazhet, që vuajnë paragjykimin e shoqërisë ndaj homoseksualitetit të tyre, ky të shkaktonte më shumë dhembje, atë që estetika aristoteliane e quante "mëshirë", qeardhje për tjetrin, të ndëshkuar nga fati dhe Zotat. Ndofa kjo ndodhte sepse në lojën e G. Deçkës nuk kishte shtirje, por një singularitet të thellë loje, ndjeshmëri, besueshmëri në gjendjen dhe rrethanën se ku dhe si vepronte personazhi i tij; madje edhe poezi, edhe humor.

Aktori i tretë që më tërhoqi më shumë vëmendje ishte Indrit Çobani në roli i Belze. Një krimplot sqimë, vërtetësi, elegancë plastike, ironi, shpoti dhe shumëçka tjetër që e bënin këtë rol nga më të realizuarit. Aktori kishte realizuar një transformim të vërtetë vizual dhe plastik,

por sidomos përshatjen me këtë homoseksual sa shpirtmadh ndaj partnerit, aq dhe shpotitës ndaj të tjerëve si njeriut të vrazhdtë Roi Kon. Asnjë fjalë nuk i ikte Indritit pa ia nxjerrë mirë domethënie. Ky aktor e ka këtë veti: nuk e harxhon fjalën kot, nuk përshpejtohet. Ai e bluan brenda vetes dhe e "ngul" fjalën të tjetri dhe të spektatori njëheri. Kjo vëmendje ndaj fjalës dhe ndjesia e përqendrimit për ta tërhequr vëmendjen të vetja, ndryshe thënë "prania" e aktorit në skenë, them se është nga cilësia e spikatura të lojës së tij.

Luiza Xhuvani luante tri role, Hana Pit, Etel Rosenberg dhe Rusi. Nga më të realizuarit m'u duk Rusi. Domethënë Rusia, Komunizmi. Qysh në çeljen e shfaqjes, regjisorit e kishte vendosur atë si një shtatore-simbol, nën emblenë e komunizmit drapër e çekan. Ajo deklamoi një referencë a sintezë të komunizmit si kinse mit i dobishëm për të mbajtur njerëzit bashkë, për t'u dhënë atyre një teori, një ideal, një shpresë, një dritë në udhën e shtetëtimin përtej, një të ardhme, përndryshe ata do ta braktisnin shpirtin të do vrapojnin pas hamburgerve, limontive, panginjies së barkut dhe eposhit. Por e gjitha kjo utopi e bukur, me të cilën u gënjyeni miliarda njerëz dhe vazhdojnë të gënjehen (sepse komunizmi është një lloj feje ere, e sofistikuar dhe fshehur nën të drejtën dhe të vërtetën absolute), nga aktorja Luiza Xhuvani deklarifikohet dhe shndërrohet në të kundërtën e vet, si ideologji e dhunes, e shtypjes, e urdhrimit tekta ajo me një detaj fare të thjeshtë në dukje, por domethënëse, thekson gjatë ligjërrimit përherë gërmën "rr". Aftëbotë gjithcka duket si një fshikullim kamzhiku, si një urdhër i prerë për t'u futur në rresht. As më pak e as më shumë: gënjje me fjalën e bukur të utopisë komuniste, ndërsa me vepërimin politik konkret kamzhiko, dhuno, burgos, pushkato, siç u provuan gjithë regjimet komuniste.

Sikundër e thashë në kryehërë, më habiti fuqia zanore e Luli Bitrit në rolin e Engjëllit. E fortë, imponuese, zotëruese. Me lëvizje të prera, si për të sjellë një shembëlltjërë sa të ardhur nga përytjimet zotërike dhe imazhet vizuale të pik-turave jo vetëm të krishtera, por edhe një farë qesëndie ndaj figurës onipotente të këtij të dërguar të Zotit, duke shakatur me mbishtresimet fantastike të mendjes, që krijojnë hierarkinë e përmbysur të engjëjve dhe halucinimet gjysmëpoetike të Prajer Uollterit (dhe të çdo Prajeri tjetër shpirtëshuar në botë, që rikrijon fantoma gjithfarëshe gjegjësisht asaj që quhet "vetëdija e rëndomtë" religjioze e besimit).

Laert Vasili si Luis Arjonson dhe Donald Shehu si Xhoi Pit i përballuan me sukses kundërthënie të shumta të personazheve të tyre dhe, çka do doja ta vlerësoja posaçërisht, sfidën e tyre si artistë ndaj shumë tabuve, që shoqëria jonë ka ngulur thellë vetes ndaj homoseksualitetit, rrjedhimisht edhe aktin emancipues që këta aktorë realizuan gjatë shfaqjes. Edhe Ina Gjonci në Harper Pit, përpos jetësimit të një gruaje të dëshpëruar, që vuante pamundësinë e marrëdhënies erotike me të shoqin homoseksual, i bashkohet kësaj sfide të dy aktorëve të mësipërm...

HOROSKOPI

- DASHI**  
Ndonjëherë nuk keni nevojë të njihni çdo hollësi të veçantë para se të përfshihen në diçka të re. Shumë detaje mund t'u ngatërrojnë, t'u trullojnë ose, më shumë gjasa, t'u japin arsye për të hequr dorë nga diçka që duhet të ndiqni tani.
- DEMI**  
Tani që keni vënë topin në lëvizje, bëni kujdes, sepse dikush mund të përipiqet marrë meritat për të gjithë punën tuaj të lodhshme. Ju e dini se kush është kandidati i mundshëm, kështu që bëni gjithçka për të mos e lejuar këtë.
- BINJAKET**  
Një nga leksionet më të rëndësishme që ju duhet të mësoni në jetë është se koha e përsosur thjesht nuk ekziston. Pra, nëse jeni duke pritur për këtë kohë mitike të përsosur për të pasur një bisedë të rëndësishme me dikë, ju do të prisni për një kohë shumë të gjatë.
- GAFORJA**  
Jo çdo gjë do të shkojë, siç do të donit ju sot, por gjërat që duhet të ndodhin nuk do të mund të pengohen prandaj ngushëllohuni me këtë. Shmangni disa investime për të cilat keni shumë dyshime.
- LUANI**  
Është një ditë e mirë që të shikoni veten në pasqyrë dhe të buzëqeshni. Trajtoni veten me një darrë të këndshme, ose blini për vete diçka që ju pëlqen. Meritoni më të mirën pas një periudhë të lodhshme.
- VIRGJERESHA**  
Imaginata, ëndrrat dhe fantazitë e tua po ju ofrojnë disa njohuri të mahnitshme për disa pikëpyetje, dhe ato mund të konfirmojnë disa dyshime. Vizionet në jetën tuaj ju japin një pamje të së vërtetës. Ju keni qenë në një mjegull reth dikujt për një kohë të gjatë.
- PESHORJA**  
Ndërkohë që nuk mund të shihni të gjithë pamjen tani, ju do të merrni të gjitha informacionet që ju nevojiten për t'u mbajtur optimist për të ardhmen. Stresi në jetën tuaj do të zvogëlohet në masë të madhe.
- AKREPI**  
Ndonjëherë ju duhet të mendoni për jetën tuaj sikur të ishte një biznes: Si po e menaxhoni produktin tuaj dhe kontributin tuaj? Nëse nuk ka balancë, mund t'i krijojë vetes probleme.
- SHIGJETARI**  
Teksa rritni, është e natyrshe që ju të filloni t'i merrni gjërat më seriozisht. Filloni të bëni pjesën tuaj për të bërë një ndryshim në botë. Sa i përket marrëdhënies në çift, mund të merrni lajme të mira.
- BRICJAPI**  
Ritmi i egër i jetës suaj do të ngadalësohet duke filluar nga sot. Përqipni t'i jepni vetes më shumë kohë për të medituar. Sa i përket aspektit profesional, përqipni të bëni pak më shumë pushim.
- UJORI**  
Kjo ditë do të jetë e mbushur me surpriza. Për sa kohë që ju e dini se çfarë kërkon, do të zbuloni disa informacione kyçe që mund të ndryshojnë gjithçka. Planet e ardhshme në punë mund të duhet të rishikohen.
- PESHQIT**  
Këshilloheni të ndërmerrni ndonjë udhëtim jashtë vendit. Mund t'u ndihmojë që të kaloni disa sfida të cilat kanë qenë të vështira. Sa i përket aspektit sentimental, mund të merrni disa informacione mbi partnerin që mund t'u shkaktojnë bezdi.

Mposhti Prishtinën në ndeshjen e fundit

Feronikeli shpallet kampion i Kosovës

Feronikeli është zyrtarisht kampion i Superligës kosovare. Ish-skuadra e drejtuar nga trajneri Sulejman Starova mposhti me rezultatin 1-0 Prishtinën në ndeshjen e fundit, duke e mbyllur kampionatin në vendin e parë me një diferencë +5 pikë nga kryeqytetasit e Mirel Josës. Ky është titulli i tretë në histori për "industrialistët". Goli i ish-futbollistit të Kukësit, Yll



Hoxha, i siguroi triumfin skuadrës që drejtohet nga trajneri Zekerija Ramadani, në sfidën më të rëndësishme të kampionatit. Prishtinës së Mirel Josës i duhej fitorja në këtë përballje për t'u shpallur kampion. Një meritë të

çmuar për shpalljen e Feronikelit kampion ka padyshim dhe ish-trajneri Sulejman Starova, i cili ndërtoi dhe drejtoi këtë skuadër në gjysmën e parë të kampionatit, teksa u largua më pas për t'i lënë vendin ish-tra-

jnerit të Flamurtarit, Ramadani, i cili bëri një punë të shkëlqyer. Ndërkohë në sfidat e tjera, Ferizaj, Flamurtari, Ballkani dhe Trepça triumfuan në shtëpi, ndërsa Drenica mposhti Lirinë në transfertë me rezul-

tatin 1-3. Goli i ish-futbollistit të Kukësit, Yll Hoxha, i siguroi triumfin skuadrës që drejtohet nga trajneri Zekerija Ramadani, në sfidën më të rëndësishme të kampionatit. Prishtinës së Mirel Josës i duhej fitorja në këtë përballje për t'u shpallur kampion. Ndërkohë në sfidat e tjera, Ferizaj, Flamurtari, Ballkani dhe Trepça triumfuan në shtëpi, ndërsa Drenica mposhti Lirinë në transfertë me rezultatin 1-3.

Timonieri italian kërkon një skuadër që të luajë në sulm, por më parë duhet "të njohë fytyrat"

Reja: Baza e Kombëtares do të jetë grupi aktual

Trajneri kuqezi bëhet gati për grumbullimin e parë

Trajneri i ri i kombëtares shqiptare Edoardo Reja ishte i pranishëm në tribunën Vip të stadiumit Selman Stërmasi për të ndjekur nga afër sfidën Tirana-Kastrioti teksa pranë tij qëndronin edhe dy ikona të klubit bardheblu Hamdi Salih dhe Ervin Bulku, të cilët pritet të jenë edhe ndihmësit e tij. Reja do të debutojë ndaj Islandës dhe ka mbërritur shumë më herët në Shqipëri pikërisht për të përgatitur sa më mirë dy sfidat e tij të para të kuqezinjve për të njohur nga afër lojtarët, grumbullimet e të cilëve do t'i nisë që në fillimin e kësaj jave ku do të punojë me një grup lojtarësh, të cilët kanë përfunduar angazhimet me klubet e tyre për këtë sezon. Në një intervistë për Top Channel, Edy Reja zbuloi disa detaje të grumbullimit të tij të parë me kuqezinjët. "Duhej t'i njihja më parë, sepse nuk kemi pasur kohën e duhur. Tani që jemi këtu duhet të njoh të paktën fytyrat, sepse mund të jenë 25 lojtarë ose 28 dhe ne kemi shumë pak kohë në dispozicion. Kështu që duhet të fillojmë të krijojmë ide të qarta. E kam një listë me 32-33 futbollistë, por është e qartë se më të favorizuarit janë ata që aktivizohen më shumë, sepse kemi nevojë për ata që janë në gjendje të më mirë fizike", tha Edoardo Reja, tra-




jneri i Kombëtares shqiptare. I pyetur për futbollistët që do të grumbullojë, Reja

pranoi se do të bazohet te grupi aktual, por pa e përjashtuar mundësinë e prurjeve

të reja në skuadër. "Do të mbaj grupin aktual të lojtarëve, por padyshim që

do të ketë edhe prurje të reja, sidomos të atyre lojtarëve të rinj që po i studioj. Më pas do të vendosim në një moment të dytë", tha Edoardo Reja.

Mënyra e lojës është një tjetër çështje që u prek nga trajneri italian i skuadrës kuqezi. "Të gjithë presin që skuadra të luajë në sulm dhe unë jam një prej tyre, por për këtë duhen elementët e duhur që duhet të marrësh në konsideratë, ndërkohë që duhet vlerësuar edhe kundërshtari që ke përballë", tha tekniku italian Reja. Në fund, trajneri Reja konfirmoi se skuadra do të udhëtojë drejt Gjermanisë për përgatitjet e saj, për shkak të klimës së ngjashme me atë të Islandës, por edhe për t'u njohur më mirë me njëri-tjetrin.



Ergys Kaçe largohet nga Panathinaikosi

Nëpërmjet një postimi në 'Instagram', mesfushori i Kombëtares, Ergys Kaçe, deklaroi se e ka mbyllur aventurën e tij me Panathinaikosin në Greqi. 25-vjeçari, që nga viti 2018 ishte dhënë në huazim nga skuadra e PAOK-ut, që ka edhe kartonin e tij, por problemet financiare të Panathinaikosit kanë bërë që të mos e blinte dot mesfushorin shqiptar. "Doja të falënderoja shokët e skuadrës dhe trajnerët që kam punuar këto muaj. Një falënderim i madh për ata që më mbështetën që nga dita e parë në skuadër. Ju uroj çdo sukses për të ardhmen, dhe të riktheheni atje ku përkisni" - shkruan Kaçe në shenjë falënderimi për Panathinaikosin. Gjithsesi, tek kampionët e PAOK shqiptari nuk ka një vend të sigurt, dhe me siguri do të gjejë një skuadër tjetër për të vijuar karrierën.

MBROJTËSI I DRITËS

Limani: Po, Partizani më ka kontaktuar

Partizani ka nisur të mendojë për sezonin e ardhshëm dhe po mendon për futbollistët me të cilët do të nënshkruajë në merkaton e verës. Mbrojtësi i Dritës, Ardian Limani duket se është një objektivi i kampionëve të Shqipërisë që kanë pasur kontakte me futbollistin kontrata e të cilit skadon në fund të sezonit. Në një intervistë të dhënë për "telegرافي.com", Limani u shpreh se ka pasur interes nga Partizani, por shton se ende nuk ka vendosur se çfarë do të bëjë me të ardhmen e tij. Kapitëni i Dritës pranoi se i vjen mirë që interesohet një klub si Partizani për shërbimet e tij. "Po kam pasur kontakte me Par-



tizinin. Ata janë shumë të interesuar të nënshkruajnë me mua, por që ende nuk kemi arritur ndonjë marrëveshje. Partizani është njëra nga skuadrat më të mëdha në Shqipëri dhe më vije mirë që më kanë vlerësuar dhe më kërkojnë. "Personalisht ende

nuk kam vendosur nëse do t'i bashkohem atyre, do të vazhdojë me Dritën apo do të nënshkruajë me ndonjë skuadër tjetër. Pas ndeshjes së fundit ndaj Ballkanit do t'i analizoj të gjitha ofertat dhe do të marrë vendimin përfundimtar", tha Limani.

MBROJTËSI KUQEZI

E ngjiti në Ligën 1, Balliu i jep lamtumirën Metzit

Fundi i këtij sezoni po sjell edhe shumë ndryshime skuadrash për legjionarët shqiptarë. I tillë është edhe rasti i mbrojtësit të djathtë të Kombëtares, Ivan Balliu. 27-vjeçari që aktivizohej tek Metz në kategorinë e dytë franceze, i ka dhënë lamtumirën ekipit, pasi me të doli në vendin e parë, duke siguruar ngjitjen për në elitën e Francës për sezonin tjetër. Me Metz këtë sezon, Balliu 28 takime, për një total prej 2.136 minutash. "Miqte e mi, më duhet të them mirupafshim. Pas 4 sezonesh te Metz, është koha që të shkoj në një aventurë të re. Faleminderit të




gjithëve, nuk do ju harroj kurrë." - shkruan Balliu në rrjetet sociale. Balliu, që nisjen e karrierës e ka pasur

tek të rinjtë e Barcelonës, tashmë duhet të shohë për një ekip tjetër ku do të vijojë karrierën.



**Fjalëkryqi (1)**



36. Nuk bëhet me lepuj.  
37. Një yll me bisht.  
40. Lodh në ekstreme.  
41. Inicialet e Duvall.  
42. Haan trainer.  
43. Janë lojërat me slot-machine.  
45. Mbarojnë fare.  
47. Të fundit në tender.  
48. Premtojnë të bëhen asa.  
50. Ka gjuhë përvëluese.  
51. Ishin mallkime shkishëruese.

VERTIKAL

1. Një film për të qeshur.  
2. Loach regjisor.  
3. Në krye të ortakëve.  
4. Shahu i fundit.  
5. Kufizojnë ekuacionet.  
6. Bien me ballë.  
7. Arte pa re.  
8. Janë binarë.  
9. Fillojnë raportin.  
10. Si morale.  
11. Eshhtë marrëveshje edhe miqësie.  
13. Eshhtë guralac i artë.  
17. Një mund të jetë një cigaresh.  
19. Janë lëvizje mashtruese.  
22. Prosper shkrimtar i famshëm.  
23. Janë finokë.  
26. Ndërmarrje Industriale Rumun.  
27. Përplassen me gatitu.  
29. Eshhtë porti i Durrësit.  
32. Eshhtë Kapriçio.  
34. Dossena e Liverpool.  
36. Një është edhe Kosova  
38. Qyteti i Turgeniev.  
39. Sorvino aktore.  
40. Altini mesfushor.  
43. Një tifoz rockstari.  
44. Institucione Ndërkombëtare Ekonomike.  
46. Entet pa ne.  
48. Hapin takimin.  
49. Inicialet e Mann.

HORIZONTAL

2. Janë sportivë ata si Ismet Bellova.  
12. Janë melodrama.  
14. Letra pa kufij.  
15. Një pjesë e atributive.  
16. Me G tregon policët e FBI.  
17. Fillojnë profesionin.  
18. Fillojnë afërsisht.  
20. Inicialet e Asimov  
21. Tipi, por jo ti.  
23. I ka kërcyer të xhindosurit.  
24. Kufizojnë një komik.  
25. Mund të jetë një energji.  
28. Sillet, vjen vërdallë.  
30. Janë diktatorë shtypës.  
31. Tutje pa çifte.  
32. Janë sekte islamike.  
33. Shteti i francezëve.  
35. Një miniaturë godine.

**Fjalëkryqi (2)**

HORIZONTAL


2. Janë sportivë ata si Ismet Bellova.  
12. Janë melodrama.  
14. Letra pa kufij.  
15. Një pjesë e atributive.  
16. Me G tregon policët e FBI.  
17. Fillojnë profesionin.  
18. Fillojnë afërsisht.  
20. Inicialet e Asimov  
21. Tipi, por jo ti.  
23. I ka kërcyer të xhindosurit.  
24. Kufizojnë një komik.  
25. Mund të jetë një energji.  
28. Sillet, vjen vërdallë.  
30. Janë diktatorë shtypës.  
31. Tutje pa çifte.  
32. Janë sekte islamike.  
33. Shteti i francezëve.  
35. Një miniaturë godine.

HORIZONTAL


36. Nuk bëhet me lepuj.  
37. Një yll me bisht.  
40. Lodh në ekstreme.  
41. Inicialet e Duvall.  
42. Haan trainer.  
43. Janë lojërat me slot-machine.  
45. Mbarojnë fare.  
47. Të fundit në tender.  
48. Premtojnë të bëhen asa.  
50. Ka gjuhë përvëluese.  
51. Ishin mallkime shkishëruese.

VERTIKAL


1. Një film për të qeshur.  
2. Loach regjisor.  
3. Në krye të ortakëve.  
4. Shahu i fundit.  
5. Kufizojnë ekuacionet.  
6. Bien me ballë.  
7. Arte pa re.  
8. Janë binarë.  
9. Fillojnë raportin.  
10. Si morale.  
11. Eshhtë marrëveshje edhe miqësie.  
13. Eshhtë guralac i artë.  
17. Një mund të jetë një cigaresh.  
19. Janë lëvizje mashtruese.  
22. Prosper shkrimtar i famshëm.  
23. Janë finokë.  
26. Ndërmarrje Industriale Rumun.  
27. Përplassen me gatitu.  
29. Eshhtë porti i Durrësit.  
32. Eshhtë Kapriçio.  
34. Dossena e Liverpool.  
36. Një është edhe Kosova  
38. Qyteti i Turgeniev.  
39. Sorvino aktore.  
40. Altini mesfushor.  
43. Një tifoz rockstari.  
44. Institucione Ndërkombëtare Ekonomike.  
46. Entet pa ne.  
48. Hapin takimin.  
49. Inicialet e Mann.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

		2		5	8			
	7	6			1	9		
			9					2
				7				
3		9						6
		5		4				
	2						3	9
							7	
1	5		2					8

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	4	2	6	8	5	1	9	3
8	9	5	1	2	3	7	4	6
6	3	1	4	7	9	8	2	5
9	1	4	7	3	6	2	5	8
3	7	8	5	9	2	4	6	1
5	2	6	8	1	4	9	3	7
1	6	3	9	4	8	5	7	2
4	5	7	2	6	1	3	8	9
2	8	9	3	5	7	6	1	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

-Breshka që ecën në rrugë të drejtë, kalon edhe kalin në rrugë të keqe.

-Të mos pranosh gabimin që ke bërë, do të thotë se bën një gabim të dytë.

-Fshirja një pjese nga e kaluara, është si të fshih një pjesë përkatëse nga e ardhmja.

-Jeta është një trëndafil, ku çdo petal është një iluzion dhe çdo gjemb është një realitet.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

K	A	D	D	D	M	E	K												
N	O	I	R	E	T	D	I	T	A										
A	H	E	T	I	M	O	R	E											
H	B	A	J	A	D	E	R	A	T										
I	P	T	T	L	T	E	U	R											
P	E	N	J		S	A	Z	A	N	I									
E	R	E	S		L	A	K	I	M										
R	A	S	T	E	T	E	T	I	A										
B	N	T	P	A	K	T	L	E	T										
O	D	A		I	N	A	L	I	Z										
L	O	R	K	E	T	E	R	R	K										
A	R	T	E	T	I	K	E	T	A										
T	E	K	B	O	M	B	R	E	D	H									
O	R	A	T	O	R	E	T	E	S	E									
G	N	O	T	A	R	E	T	T	M	T									
E	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T									
R	S	L	R	E	T	E	E	R	I	K									
P	E	L	O	T	A	D	V	M	A										
S	O	T	R	T	A	R	E	E	T										
T	R		G	P	A	R	E	T	E										
E	T	L	A	R	I	T	M	I	A										
F	I	L	I	Z	A	T	E	A	G	A									
A	D	I	T	E	T	O	M												
N	O	B	I	L	E	B	A	N	A	L	E								

*Thënie të mençura*

- Nëse mbyllni derën për të gjitha gabimet, e vërteta do të qëndrojë jashtë.
- Gruaja është si trëndafili: petalet bien për një javë, por gjembat mbeten.
- C'ke në xhep ta marrin menjëherë, c'ke në tru sta marrin dot kurrë.
- Disa njerëz shfryjnë sepse trëndafilat kanë gjemba. Unë jam mirënjohës që gjembat kanë trëndafila.

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

A	V	A	T	I	S	A	L	A	M	I	N	A	
L	A	N	A	F	E	E	A	R	I	S			
A	L	N	E	N	E	N	A	P	A	T	O	P	
N	E	G	E	R	S	I	R	A	T	R	I		
T	A	S	M	O	D	E	U	F	M	I	R		
S	A	M	T	A	R	A	F	F	A				
M	B	R	O	N	I	N	A	R	I	E	T		
H	A	B	E	R	T	O	M	A	R	A			
R	I	T	E	S	E	R	I	E	T				
T	E	M	E	B	E	L	E	L	I	V			
O	T	E	M	E	R	I	T	A	S	A	M		
M	A	R	I	L	A	N	A	A	R	M	A	N	I
M	A	R	N	T	E	P	R	M	I	T	E		
T	N	A	I	U	M	A	D	T	E	S			
S	T	U	S	E	N	D	E	R	E	S			
T	E	L	T	U	N	D	I	M	I	A	U		
E	N	K	E	N	D	I	M	I	S				
E	R	A	K	A	N	A	B	E	L	A			
I	T	A	A	A	N	N	A	B	E	L			
Z	E	L	L	I	L	E	M	E	D				
O	K	A	N	A	I	S	A	R	E	N	A		
Q	E	L	L	I	L	E	M	E	D				
E	B	A	R	I	T	O	N	L	E	R	A		
T	O	K	A	A	L	L	E	R	A				
M	I	N	I	M	A	L	E	S	T	E	R		

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

